



Plani i Mbrojtjes Sociale
Bashkia Korçë

2019 – 2021

Table of Contents

HYRJE	3
Reformat në sistemin e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror	4
ANALIZA E FAKTOREVE TE PERFSHIRE NE OFRIMIN E SHERBIMEVE SHOQERORE	5
Situata e mbrojtjes shoqerore ne bashkine Korçë	5
Situata e grupeve vulnerabël dhe nevojat e tyre për shërbime.....	6
Partneriteti me OJF-të.....	7
PLANI SOCIAL I BASHKISË KORÇË 2019 - 2022	8
Misioni	8
Vizioni	8
Plani i Shërbimeve Sociale - kërkesë ligjore por dhe detyrim ndaj shtresave ne nevoje	8
Situata e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Bashkinë Korçë.....	9
Rruga që duhet ndjekur për t’i garantuar shërbimet e kujdesit shoqëror qytetarëve të Bashkisë Korçë.....	10
Zhvillimi i shërbimeve ekzistuese:.....	11
Zhvillimi i shërbimeve të reja:.....	11
Objektivat afat-mesme te Planit Social 2018 – 2020 te Bashkise Korcë	11
Strategjia e zbatimit të planit social.....	13
Rreziqet për zbatimin e planit	14
Aneks: 1 Plan i Veprimit	15
Aneks 2 SHËRBIMET SHOQËRORE EKZISTUESE NË BASHKINË ËKORÇËS.....	30
Aneks 3. Legjislacioni.....	36

HYRJE

Plani i Shërbimeve Sociale të Bashkisë Korçë synon të adresojë nevojat dhe të drejtën e grupeve vulnerabël për shërbime sociale, fuqizimin e strukturave përgjegjëse vendore, si dhe përmirësimin e shpërndarjes dhe llojshmërisë së shërbimeve.

Plani është hartuar përmes një procesi konsultimi me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse vendore, shoqërisë civile, ofrues të shërbimeve si dhe grupeve në nevojë për të garantuar një vlerësim sa më afër nevojave reale të tyre dhe mundësive për adresuar këto nevoja nga aktorë të ndryshëm.

Reforma e re administrative-territoriale ka sjellë një sërë ndryshimesh në kompetencat e njësive të qeverisjes vendore si në shtrirje ashtu edhe në krijimin dhe administrimin e shërbimeve në nivel vendor. Shërbimet e kujdesit shoqëror tashmë konsiderohen si funksion i vetë pushtetit vendor, të decentralizuara, edhe pse këto shërbime të kujdesit shoqëror, do vazhdojnë të kenë mbështetjen teknike, institucionale dhe financiare të burimeve të buxhetit të shtetit.

Politikat dhe prioritetet e shërbimeve të kujdesit shoqëror janë prerogative e MSHKS, ndërsa bashkitë kanë përgjegjësinë kryesore për planifikimin dhe buxhetimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në territorin e tyre.

Në këtë kuadër, bashkia e Korcës ka marrë përsipër hartimin e Planit Social, të prezantuar në këtë dokument. Përgjatë këtij procesi, ajo është mbështetur UNICEF (si pjesë e programit të përbashkët të Qeverisë Shqiptare me Agjensitë e OKB-së, Leave No One Behind financiar nga SDC) dhe OJF-të Ndhim për Fëmijët në një fazë të parë, dhe Eurpartners Development në fazën përfundimtare. Ky bashkëpunim është përqëndruar në vlerësimin e nevojave lidhur me hartimin e planit, buxhetimin e tij dhe identifikimin e burimeve financiare për ta zbatuar, duke rritur kapacitetet vendore në këtë drejtim.

Hendeku ndërmjet nevojave për shërbime sociale dhe sistemi aktual i shërbimeve publike në nivel vendor është i njohur. Aktualisht ky hendek mbulohet deri në një farë shkalle nga organizatat jo-fitimprurese (OJF-të) operatorët privatë që ofrojnë shërbime sociale dhe organizatat fetare, të cilat të mbështetura nga organizmat ndërkombëtare dhe në një masë më të vogël nga buxheti i shtetit, ofrojnë shërbime për kategoritë në nevojë.

Plani i shërbimeve sociale të Bashkisë Korçë bazohet në ofrimin e një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë, si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato vendore, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale.

Reformat në sistemin e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror

Qeveria shqiptare, e mbështetur nga UNICEF, që prej vitit 2012 ka ndërmarrë një reformë të thellë të sistemit të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë. Sot, ne kemi një realitet të ri administrativ dhe ligjor, përgjegjësi dhe kapacitete reja për të përmbushur dhe zhvilluar. Mbrojtja Sociale, qendërzohet tek individi, dhe ka si objektiv “Zhvillimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror të decentralizuara, në mënyrë që grupet vulnerable të përfshihen në programe të mbrojtjes sociale dhe që inkurajojnë pjesëmarrjen e plote dhe efektive të këtyre grupeve në shoqëri”. Është e qartë se shërbimet e kujdesit shoqëror luajnë një rol kyç në përmirësimin e cilësisë së jetesës të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë. Vizioni ynë për këto shërbime është krijimi i një sistemi të integruar për kujdesi shoqëror që është koherent dhe i qëndrueshëm në nivel strategjie, politikash, buxhetesh dhe kapacitetesh.

Në përputhje me këtë vizion dhe objektiva, Ligji për Vetëqeverisjen Vendore¹ i miratuar në Dhjetor 2015, i ngarkon njësitë e qeverisjes vendore me një sërë përgjegjësish të reja e të rëndësishme në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke qenë se për shkak të afërsisë me komunitetin, niveli vendor konsiderohet si më i përshtatshmi për ofrimin e shërbimeve shoqërore për grupet vulnerable që përfitojnë nga këto shërbime.

Për të përmbushur synimin e krijimit të një sistemi të integruar të kujdesit shoqëror, Ligji i Shërbimit e Kujdesit Shoqëror² perkufizon dhe detajon më tej shërbimet dhe rolin e përgjegjësive ligjore të të gjithë aktorëve të përfshirë në krijimin e kushteve dhe garantimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në nivel qendror dhe vendor.

Këto shërbime përfshijnë ofrimin e shërbimeve parashoqërore, shërbime në qendrat komunitare dhe ato të zhvillimit, në qendrat rezidenciale dhe strehëzat, shërbimet e kujdesit alternativ për fëmijët, shërbime të specializuara, shërbime të këshillimit me telefon dhe online në qendrat multifunksionale etj., ndaj fëmijëve në nevojë, viktimave të dhunës, abuzimit, trafikimit, grave, dhe të moshuarve.

Po kështu, legjislacioni përcakton detyrimet specifike për shërbimin e kujdesit shoqëror në nivel vendor, që përfshijnë edhe ngritjen e Njërive të Referimit dhe Vlerësimit të Nevojave, (NJRVN), të Mbrojtjes së Fëmijës (NJMF), të Dhunës në Familje (NJDHF) me përgjegjësitë, dhe kërkesat profesionale përkatëse³

Për ta bërë edhe më të qartë se shërbimet e kujdesit shoqëror takohen me përfituesit në nivel lokal, atje ku janë fëmijët, gratë, të moshuarit në nevojë si dhe personat me aftësi të kufizuara, dhe se Bashkitë kanë përgjegjësinë ligjore të ofrojnë shërbimet e integruara sociale, në Mars të vitit 2017 u nënshkrua Pakti Social mes gjithë Kryetarëve të bashkive të Shqipërisë dhe përfaqësuesve të Qeverisë. Ky Pakt shërben për të përforcuar zbatimin e Ligjit për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror; ai është një udhëzues hap pas hapi i punës dhe detyrimeve që duhet të përmbushë përkatësisht Qeveria dhe Bashkia; zbatimi i tij shpreh dhe provon konkretisht vullnetin e Bashkisë për të mbështetur grupet në nevojë pa hezitim dhe me cilësi, sipas kërkesave ligjore.

Viti 2018 do duhej të ishte viti i parë që Shërbimet e Kujdesit Social u jepën grupeve vulnerable në nivel bashkie, përmes përfshirjes së Njërive të Referimit për Vlerësimin e Nevojave, Njërive për Mbrojtjen e Fëmijëve, Ndërmarrjeve Sociale, Qendrave Shumëfunksionale të ngritura sipas kërkesave të ligjit. Viti 2019 do të jetë viti i parë që do të krijohet nga qeveria dhe bashkia Fondi Social dhe që

¹ Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”

² Ligji nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë

³ Ligji nr 163/2014 “Për Urdhërin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë dhe Ligji nr. 40/2016 “Për Urdhërin e Psikologëve në Republikën e Shqipërisë”

procesi i Planifikimit të Shërbimeve të Kujdesit Social sipas shportës së shërbimeve do të ndodhë në nivel lokal bazuar në Planin Social të hartuar dhe miratuar nga Bashkia. Bashkia Korçë duhet të bëhet prioritare për të përfituar mbështetje nga Fondi Social, dhe nga financimet e donatorëve vendas e të huaj.

Për këtë, sfida jonë është plotësimi pa vonesa të mëtejshme i arkitekturës institucionale në nivel bashkie, siç kërkohet nga ligji dhe Pakti Social. Legjislacioni dytësor dhe kthimi i tij në instrumente të lehta dhe të gatshme për përdorim është kryesisht i miratuar nga qeveria; instrumentat e rinj financiarë, përveç atyre tradicionalë – kontributi i qeverisë në Fondin Social – janë krijuar me buxhetin e shtetit 2019. Bashkia duhet të përmbushë detyrimet e saja ligjore, dhe zbatojë vullnetin e saj për të ofruar dhe garantuar mbrojtje dhe zhvillim qytetarëve të Korçës që i përkasin grupeve vulnerabël, në frymën e re të ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror.

ANALIZA E FAKTOREVE TE PERFESHIRE NE OFRIMIN E SHERBIMEVE SHOQERORE

Situata e mbrojtjes shoqerore ne bashkine Korçë

Aktualisht ne Bashkine Korçë ka rreth 15 qendra qe ofrojne sherbime te kujdesit shoqeror, dhe kemi nje bashkepunim te frytshem te Bashkise me organizatat jo-publike te perfshira ne ofrimin e ketyre sherbimeve permes bashkefinacimit te aktivitetit apo mbulimit te qerave dhe shpenzimeve te tjera korrente si uje, drita, ngrohje per nje pjese te tyre. Në situatën e re të ndryshimeve pas reformës territoriale, por dhe ndryshimeve aktuale në legjislacionin përkatës, Drejtoria e Sherbimeve Sociale dhe Komunitare dhe të gjithë aktoret e tjere publike dhe jo-publike gjenden perballë një sërë nevojash e sfidash për të ardhmen ne lidhje me egzistencen, cilesine dhe qendrueshmerinë e sherbimeve te kujdesit shoqeror ne Bashkine Korçë.

- Në Bashkinë Korçë ka një oferte të qenësishme të shërbimeve⁴ për grupet vulnerable si femijet, të moshuarit, PAK, viktimat e dhunes ne familja apo trafikimit si nga ofruer publik ashtu edhe jo publik, por ka nje shperndarje jo te balancuar ne territor – shumica e ketyre sherbimeve jane perqendruar ne qytetin e Korçes. Zgjerimi i bashkise per shkak te reformes administrative nuk eshte shoqeruar ende edhe me prezencen ne te gjithë territorin te teresise se sherbimeve te kujdesit shoqeror. Adresimi i mungeses se qendrave multifunksionale ne Njesite Administrative do e lehtesonte kete situatë te re.
- Drejtoria e Kujdesit Social në Bashki, përbëhet nga një staf prej 20 personash, ku janë të përfshirë edhe administratorët e shtatë njësive administrative, të cilët janë 1 për njësi, dhe ky kapacitet punonjësish konsiderohet minimal për një njësi që kryen funksione të shumëfishta. Për më tepër që punonjësit kryejnë funksione, të cilat nuk janë parashikuar në strukturë, si çështje të barazisë gjinore, mbrojtja e të drejtave të femijeve e kështu me radhë.
- Eshte e domosdoshme **te krijohet Njesia e Vlersimit dhe Referimit te Nevojave brenda Drejtorise së Kujdesit Social**, ne menyre qe te koordinohet sa me mire puna mes specialisteve brenda drejtorise, dhe si nje mundesi per menaxhimin me efektiv te rasteve, por edhe per koordinim me te mire me institucionet e tjera.
- Verehet nje nevoje ne rritje, dhe e pambuluar per sherbime qe kerkojne adresim te menjehershëm. Eshte e nevojshme te plotesohet mungesa sherbimeve te emergjences dhe te synohet konsolidimi i ketyre sherbimeve - strehezave, sidomos per femijet ne situatë emergjente. Eshte gjithashtu i nevojshëm perputhja e kapaciteteve dhe specializimeve te stafit te bashkise per t'u perballur me nevojat per sherbime te femijeve jetime dhe te rinjve 16-18 vjeçare në emergjencë.
- Duke qenë se tradita e strukturave se Sherbimeve te Kujdesit Shoqeror lidhet me ofrimin e

⁴ Shih Aneksin 2

pagesës së NE dhe PAK dhe më pak me Shërbimet sociale, konstatohet mosnjohja e plote e roleve dhe përgjegjësi nga Administratorët Socialë sidomos në NJ.A, e linjave të raportimit, mungesës së qasjes së nevojshme dhe formimit arsimor e profesional, duke krijuar vështirësi në ofrimin dhe referimin tek shërbimet ekzistuese, nisur që nga kufizimet për realizimin e vizitave në familje, etj.

- Mospërputhja në përgjithësi e profesionit të punonjesit, me pozicionin e punës, detyrën apo rolin që luajnë në praktiken në shumicën e rasteve, sidomos me Njesitë Administrative, kemi të bëjmë me administratore sociale që historikisht kanë mbuluar pagesat në cash, por në funksion të cilësisë së shërbimit që duhet të ofrojnë, trajtohen për njohjen me elementët fillestarë të procedurave për mbrojtjen e fëmijëve, dhunën në familje apo barazine gjinore. Është e nevojshme të mbështetet me burime njerëzore dhe financiare një ristrukturim dhe plotësim gradual i stafit me kompetenca të posaçme, në përputhje me legjislacionin përkatës mbi shërbimet e kujdesit shoqëror.
- Përveç nevojave për të përpunuar kompetencat profesionale të stafit me perkufizimet ligjore të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe me nevojat reale në territor, duhet të adresohen edhe burimet financiare dhe logjistike të pamjaftueshme (internet, transport, telefona, materiale dhe pajisje zyre, etj.) për të arritur distancat e rritura midis shërbimeve/zyrave dhe qytetarëve, sidomos në NJA-të e reja të përfshira në bashki. Është e nevojshme të garantohet mbështetja buxhetore e këtyre elementeve të rëndësishme dhe bazike të punës së Drejtorisë së Kujdesit Social, për garantuar qëndrueshmërinë e shërbimeve, shtimit të numrit të tyre dhe eliminimit të rrezikut të uljes së numrit dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara aktualisht.

Nga gjithë sa më lart rezultojnë se nevojitet të vazhdojë të thellohet ndryshimi i balancës në favor të idesë që filozofia dhe modeli i ofrimit të shërbimeve nga ai aktual i ofrimit të NE drejt një qasje me fokus shërbimet direkte për individët dhe familja, e cila arrihet përmes modelit të menaxhimit të rastit dhe punës ndërsektoriale, si në nivel DSHSK ashtu edhe NJA-je, duke përdorur e kombinuar burimet e aktorëve të ndryshëm relevantë publikë dhe jopublikë. Kjo qasje do të mundësojë gjithashtu reflektimin e ndryshimeve të fundit legjislative, veçanërisht ato ligjin e ri për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe të VKM-ve të tij, të cilat tashmë e kanë rritur përgjegjësinë e Bashkisë për të adresuar efektivisht nevojat për shërbime të gjithë kategorive përmes menaxhimit të rastit në NJVNRR dhe punonjësve socialë që do mund të punësohen me këtë qëllim.

Situata e grupeve vulnerabël dhe nevojat e tyre për shërbime

E tashmja dhe ardhmja na përballin me nevojën për ngritjen e shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror nga bashkia, për t'iu përgjigjur nevojave komplekse dhe të paplotësuara deri më tani, të qytetarëve, fëmijë e të rritur. Nevojat prioritare për shërbime përfshijnë drejtimet e mëposhtme:

- Ngritjen dhe shpërndarjen e shërbimeve edhe në nivel NJA-je, sidomos ato jashtë qytetit të Korçës, për t'iu përgjigjur nevojave të komunitetit, aty ku ai jeton, si ndërtimin e qendrave multifunktionale komunitare në varësinë e bashkisë të cilat të ofrojnë shërbime, sa më të larmishme, përfshi edhe ato parandaluese, për të gjitha kategoritë vulnerabël të identifikuar, si për fëmijët dhe të rriturit. Të rëndësishme konsiderohen gjithashtu shërbimet në familje për PAK apo të moshuar apo edhe ato levizëse, sidomos për banorëve e zonave rurale, të cilët banojnë larg qendrës së NJA-së.
- Ofrimin e shërbimeve 24 orëshe për fëmijët në nevojë për mbrojtje pranë bashkive dhe NJA-ve si dhe ngritjen e qendrës së emergjencës (72 orëshe) për pritjen e shpejtë të rasteve, sidomos ato në situatë rruge.
- Ofrimi i shërbimeve që synojnë fuqizimin e viktimave të DHF dhe trafikimit, duke përfshirë ngritjen e një strehe emergjence, ofrimin e banesave sociale, kurse profesionale dhe punësimi, ndërtimin e çerdheve dhe kopshteve, në mënyrë që nënat kryefamiljare të

sigurojnë kujdesin për fëmijët e tyre, që të mund të punojnë dhe të mbështesin veten financiarisht.

- Ndërtimin e shërbimeve për fuqizimin e personave në nevojë (veçanërisht të rinjve dhe komunitetin Romë dhe Egjiptianë), nëpërmjet shërbimit të ndërmjetësimit në Bashki për punësimin e tyre si dhe ofrimin e programeve të formimit profesional pranë NJA-ve, si dhe në përshtatje me tipologjinë e punësimit në zonat rurale dhe ato turistike.
- Ndërtimi i shërbimit të kujdestarisë për fëmijët, i cili ende nuk ka filluar të aplikohet në Korçë
- Ngritjen e një qendre komunitare për të rinjtë me probleme të abuzimit me substancat.
- Ngritjen e një qendre komunitare për të sëmuretë mendore.
- Ndërtimi i programeve parandaluese për edukim dhe ndërgjegjësim, që targetojnë problematikat e grupeve të identifikuar vulnerabël, si komuniteti Rom dhe Egjiptian, të pastrehët, gratë viktime të dhunës në familje dhe trafikimit, të rinjtë në risk për abuzim me substanca, etj. (duke përfshirë programe ndërgjegjësuese kundër diskriminimit, programet e prindërimit, trajtimin e dhunuesve nëpërmjet grupeve mbështetëse për menaxhimin e zemërimit, këshillimin për varësinë nga substancat, kurset profesionale, etj).

Partneriteti me OJF-të

OJF-të kanë një rol shumë të rëndësishëm në hartimin e politikave dhe shpërndarjen e shërbimeve. Është një faktor mjaft pozitiv që OJF-të janë përfshirë në hartimin dhe konsultimin e shumë prej strategjive vendore dhe kombëtare. Roli i OJF-ve është thelbësor në lidhje me hartimin e politikave dhe shpërndarjen e shërbimeve shoqërore. Në total, në territorin e Bashkisë së Korçës operojnë një sërë organizatash të shoqërisë civile, të cilat aktualisht ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për mbrojtjen e fëmijëve, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, gratë, etj, por edhe realizojnë aktivitetet e fuqizuese për zhvillimin e komuniteteve apo target grupeve të caktuara, si të rinjtë, gratë viktime të dhunës në familje, komunitetin rom dhe egjiptian, fëmijët, PAK si edhe familjet e varfra.

DSHSK bashkëpunon drejtpërsëdrejti dhe ofron mbështetjen e saj për 6 organizata, diku duke ofruar godinen dhe diku duke mbuluar disa shpenzime utilitare. OJF-të konsiderohen si një strukturë e rëndësishme në ofrimin e shërbimeve, pasi mund të veprojnë edhe më shpejt se institucionet publike dhe kanë mundësi për të ofruar një cikël të plotë të shërbimeve. Ata e shohin të rëndësishëm gjithashtu rolin e bashkisë në koordinimin, planifikimin, monitorimin e shërbimeve dhe pse jo edhe bashkë-financim për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Ndonëse bashkëpunimi i deritanishëm me OJF-të konsiderohet mjaft i frytshëm nga DSHSK, sidomos në kushtet e mbështetjes së ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë Korçë, na duhet të mbajmë parasysh se këto shërbime varen nga donatorët, janë të kufizuara në mbulim si dhe në qëndrueshmëri, ndërsa detyra dhe detyrimi ligjor për të garantuar ekzistencën e shërbimeve të kujdesit shoqëror do të mbeten gjithnjë Bashkisë.

PLANI SOCIAL I BASHKISË KORÇË 2019 - 2022

Misioni

Bashkia e Korçës do të vendosë fokusin tek ofrimi i shërbimeve të standartizuara dhe cilësore të kujdesit shoqëror, për të mbuluar nevojat sociale në rritje, të grupeve vulnerabël dhe komunitetit. Ky mision synon të përmbushet përmes zhvillimit të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, ndërtimit të shërbimeve të reja dhe shpërndarjes së tyre sa më pranë qytetarëve, sipas modeleve të praktikave të mira bashkëkohore.

Vizioni

Shërbimet sociale në Bashkinë e Korçës do të jenë gjithëpërfshirëse, të shpërndara në territor, të shumëllojshme dhe të bazuara në nevojat sociale gjithnjë në rritje të popullatës. Ato do të ofrohen në përputhje me standardet dhe kornizën ligjore të shërbimeve sociale, dhe bazuar në qasjen me personin në qendër, atë multisektoriale dhe të menaxhimit të rastit. Bashkia e Korçës do të konsolidojë një sistem të balancuar shërbimesh sociale të cilat do të kenë në fokus grupet në nevojë, duke synuar një mbulim më të mirë të nevojave ekonomike të tyre, një mbulim më të plotë me shërbime të tjera të përkujdesit shoqëror nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, dhe ndërtimit të shërbimeve të reja sipas modeleve të praktikave të mira bashkëkohore dhe shtrirjes së tyre në të gjitha njësitë administrative. Sistemi i shërbimeve të përkujdesit shoqëror në Korçë do të ketë në dispozicion burime njerëzore, materiale dhe financiare të mjaftueshme për të siguruar shërbime të standartizuara.

Plani i Shërbimeve Sociale - kërkesë ligjore por dhe detyrim ndaj shtresave në nevojë

Plani i Shërbimeve Sociale i Bashkisë Korçë (2018-2021) është një dokument politikash specifike për grupet dhe komunitet e targetuara në territorin e Bashkisë, në përputhje të plotë me Strategjinë e Mbrojtjes Sociale (2015-2020) dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020), dhe detyrimeve e përgjigjesive që burojnë nga Ligji për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror. si dhe me Paktin Social të firmosur nga Kryetarët e Bashkive të Republikës së Shqipërisë me përfaqësues të Qeverisë, si dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave⁵ që sigurojnë legjislacionin sekondar në mbështetje dhe zbatim të ligjeve të sipër-përmendur. Ky Plan do të jetë pjesë përbërëse/integrale e Planit të Zhvillimit të Bashkisë Korçë dhe në këtë kuadër do t'i mundësojë strukturave vendimmarrëse të Bashkisë të përcaktojnë fushat prioritare dhe alokimin e burimeve të disponueshme.

Plani Social, synon të krijojë mekanizmat e domosdoshëm administrativë, strukturat institucionale në shërbim të grupeve vulnerabël, të identifikojë kostot dhe burimet financiare, në mënyrë që shërbimet e kujdesit social të ofrohen për familjet, fëmijët dhe grupet e tjera vulnerabël në Bashkinë e Korçës,

⁵ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 23.2.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social".

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar".

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 3.10.2018 "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes".

Udhëzimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 689, datë 2.10.2018 "Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore".

sipas një projekti të hartuar mirë, i cili monitorohet dhe azhurnohet rregullisht. Dokumenti i Planit të Shërbimeve Sociale synon të jetë dokument orientues i mbështetjes nga donatorët, nga OJF-te që udhëheq vendimarrjen e bashkise për të siguruar çdo mbështetje, institucionale, logjistike dhe financiare ndaj DSHSK që në bashkinë e Korçës grupet vulnerable dhe në nevojë trajtohen sipas parashikimeve ligjore, dhe jo në mënyrë të improvizuar, të sforcuar dhe me vështirësi subjektive.

Monitorimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave të këtij plani do të paraqitet në mënyrë periodike dhe do të jetë pjesë e diskutimeve të strukturave drejtuese, Këshillit Bashkiak dhe partnerëve të tjerë vendorë.

Përgjegjëse për monitorimin e zbatimit e PSHS do të jetë DSHSK-së me sektorët përkatës, të cilët mbledhin të dhëna dhe identifikojnë boshllëqet në informacionin që nevojitet. Ajo do të ketë gjithashtu rol koordinues dhe bashkërendues mbi ecurinë e zbatimit dhe do të ketë përgjegjësinë e përgatitjes së progres raporteve vjetore. Në lidhje me monitorimin dhe kordinimin plani parashikon veprimtari të përmirësimit të sistemit të të dhënave, hartimit të instrumentave të standartizuara të raportimit dhe MV, si dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit me strukturat e nivelit rajonal, qendror dhe OJF-të.

DSHSK është gjithashtu përgjegjëse për kryerjen e një hartëzimi të plotë të shërbimeve në territorin e Bashkisë, duke përfshirë hartëzimin e të gjithë aktorëve që janë aleatë të mundshëm. DSHSK e azhuron periodikisht hartën duke futur gradualisht të gjitha shërbimet e reja të krijuara sipas angazhimeve në Paktin Social, dhe legjisllacionin në fuqi. Instrumenti i hartëzimit të shërbimeve i shërben vlerësimit të mbulimit me këto shërbime të territorit të bashkisë, mundëson programimin e mbështetjes së këtyre shërbimeve me burime njerëzore dhe financiare dhe gjithashtu vlerëson qëndrueshmërinë e ofrimit të tyre duke informuar në kohë vendim-marrjen për masat përkatëse sipas rastit.

Situata e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Bashkinë Korçë.

Bashkia Korçë regjistron një popullsi prej rreth 75.994 banorë, dhe e plotëson kërkesën ligjore të pasjes së 1 punonjësi social për 6-10.000 banorë. Përbëhet nga 8 Njësi Administrative – Korçë, Qendër Bulgarec, Voskop, Voskopojë, Lekas, Vithkuq, Mollaj dhe Drenovë. Ka 1 qytet dhe 62 fshatra të shtrirë në një sipërfaqe prej 805.99 km². Në Bashkinë Korçë shërbimet e kujdesit shoqëror rezultojnë të përqëndruar në qytetin e Korçës, me një shpërndarje jo të balancuar në territor dhe midis kategorive. Numri i përfituesve të totalit të shërbimeve të kujdesit shoqëror arrin në rreth 8500 persona ku përfshihen fëmijët, gra dhe të moshuar.

Shërbimet publike që ofrohen në Bashkinë Korçë janë për të Moshuarit, për Personat me Aftësi të Kufizuar (3 Qendra – Qendra Rezidenciale e Zhvillimit Mendor, Qendra Ditore e Zhvillimit dhe Shkolla Speciale), fëmijët (ka 3 Qendra ditore në shërbim të tyre), si edhe streheza për grate e dhunuara. Ndërkohë, ka një Qendër Multifunkionale jo-publike ndërsa këto mungojnë në NJA-të e Bashkisë Korçë, edhe pse do ta lehtësonin ndjeshëm ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në territorin e zgjeruar nga reforma administrative. Edhe pse ekziston risku i paqëndrueshmërisë së shërbimeve nga OJF-te, mekanizmi i bashkefinancimit të këtyre shërbimeve nga bashkia, deri me sot ka mundësuar në vazhdimësi shërbime për kategoritë në nevojë si fëmijët në situatë dhune, PAK, të moshuar të vetmuar, të rinj në vështirësi apo dhe programe të fuqizimit ekonomik për kategori në territorin e

bashkisë Korçë.

Paralel me zgjerimin e territorit të bashkisë, është konstatuar nevoja në rritje e komunitetit për shërbime që kërkojnë adresim të menjëhershëm; reagimi i shpejtë ndaj këtyre nevojave çënohet nga disa kufizime, disa prej tyre janë numri i shërbimeve të ofruara, i ambienteve, po ashtu edhe ai i stafit i kufizuar i bashkisë dhe NJA-ve në raport me numrin e rritur në mënyrë të ndjeshme të popullatës rezidente të bashkisë.

Burimet njerëzore aktuale, mbingarkesa në punë dhe konsumimi profesional, por edhe burimet financiare dhe logjistike të pamjaftueshme (internet, transport, materiale dhe pajisje zyre, etj.) për të arritur distancat e rritura midis shërbimeve/zyrave dhe qytetarëve, sidomos në NJA-të e reja të përfshira në bashki, bëjnë që cilësia e shërbimeve të ofruara të ketë nevojë për përmirësim. Kjo është një situatë që ka nevojë të korrigohet, për të siguruar njëherësh zbatimin e detyrimeve ligjore dhe ofrimin cilësor të shërbimeve të kujdesit shoqëror duke mos u mohuar njerëzve që kanë nevojë të drejtën njerëzore dhe ligjorë për të përfituar prej këtyre shërbimeve.

Rruga që duhet ndjekur për t'i garantuar shërbimet e kujdesit shoqëror qytetarëve të Bashkisë Korçë

Reforma e ndërmarrë në fushën e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, ndryshimet ligjore dhe Ligji i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror dhe VKM-të e tij kanë rritur dhe ngarkuar drejtpërdrejt Bashkinë me përgjegjësinë për të adresuar efektivisht nevojat për shërbime të gjithë kategorive në nevojë. Këto ndryshime ligjore sjellin nevojën që të ndryshojë filozofia dhe modeli i ofrimit të shërbimeve nga ai aktual i ofrimit të NE drejt një qasje me fokus shërbimet direkte për individët dhe familja, e cila arrihet përmes modelit të menaxhimit të rastit dhe punës ndërsektoriale, si në nivel DSHSK-je ashtu edhe NJA-je, duke përdorur e kombinuar burimet e aktorëve të ndryshëm relevantë publikë dhe jopublikë.

Është e qartë se hapi i parë për të zbatuar ligjin, dhe përmbushur vullnetin e Bashkisë për sigurimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë e Korçës mbetet zbatimi i ligjit për ngritjen e Njësive së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave në mënyrë që të mund të koordinohet më mirë puna midis specialistëve brenda drejtorisë, por edhe si një mundësi për menaxhimin më efektiv të rasteve dhe koordinim më të mirë me insitucionet e tjera bashkiake, apo dhe në nivel rajonal (si shëndetësia, arsimit, policia) dhe atyre vendore nuk funksionon në nivelet e duhura.

Ngritja e kësaj Njësie, plotësimi me punonjës social dhe mjete logjistike i Njesive të tjera, është kusht *sine qua non* për të siguruar mbështetje financiare nga Qeveria, ndërsa e bën gjithnjë e më të lehtë dhe më profesional koordinimin e mbështetjes për grupet në nevojë edhe me donatorët dhe OJF-të që ushtrojnë këtë veprimtari në Bashkinë Korçë – e gjithë kjo do garantonte shërbim në kohë dhe cilësor për qytetarët korçarë që i përkasin grupeve vulnerabël.

Bazuar në vlerësimin e nevojave për shërbime në territorin e Bashkisë Korçë, i cili është realizuar përmes konsultimit me stafin e bashkisë, ofruesit e shërbimeve apo partnerë dhe institucione relevante, si dhe mbi shportën e shërbimeve bazë, janë hartuar prioritetet e bashkisë Korçë në zhvillimin e shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror dhe atyre të reja, të prezantuara më poshtë. Këto prioritetet janë reflektuar edhe në planin e veprimit 2018-2021. Ky plan veprimi është ndërtuar mbi dy shtylla kryesore, atë të zhvillimit dhe përmirësimit të shërbimeve ekzistuese, dhe atë të krijimit

dhe zhvillimit të shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror.

Zhvillimi i shërbimeve ekzistuese:

- a) Fuqizim i strukturave publike në bashki dhe NJA si dhe shërbimet shoqërore, duke marrë në konsideratë rritjen e popullatës dhe territorit që duhet të mbulojë bashkia me shërbime.
- b) Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve publike nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës dhe mbështetjes me logjistikë.
- c) Shtimi i nje Qendre Ditore per moshen e trete duke i cuar ne 5 dhe shtimi e zhvillimi i shërbimeve qe ato ofrojne
- d) Informimi i qytetarëve me metoda të diversifikuara në raport me nivelin dhe nevojat e tyre specifike lidhur me të drejtat e tyre dhe shërbimet nga të cilat mund të përfitojnë.
- e) Informimi i institucioneve dhe aktorëve relevantë mbi rolet e përgjegjësive të secilit dhe plotësimi i detyrimeve në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- f) Ngritja e Qendrave Shumëfunktionale edhe në nivel NJA, sipas modelit te Qendres ne nivel Bashkie, ku do të ofrohen shërbime të integruara dhe të larmishme për të gjitha kategoritë vulnerabël si për fëmijët dhe të rriturit, shërbime lëvizëse dhe shërbime në familje, si dhe programe edukimi të prindërimit të shëndetshëm, dhe parandalimit të dhunës.
- g) Shërbimi i kujdestarisë për fëmijët.
- h) Mbeshtetja dhe shtimi i numurit te Mensave sociale për të varfrit, të moshuarit e vetmuar dhe kategori të tjera në nevojë me partneret, duke e cuar ne tre numurin e tyre ne Bashkine Korce.
- i) Qendër ditore për të sëmurët mendorë, per te gjitha kategorite dhe moshat.
- j) Zhvillimi cilesor i shërbimeve qe ofron Qendra per trajtimin e viktimave DHF.

Zhvillimi i shërbimeve të reja:

- a) Ngritja e nje qendër emergjence dhe shërbime 72 orëshe për fëmijët në nevojë mbrojtje, dhe viktimat e trafikimit.
- b) Shërbimi 24 orësh në bashki dhe NJA për përgjigjen ndaj nevojave emergjente të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.
- c) Qendër komunitare për të rinjtë me probleme të abuzimit me substancat.
- d) Shërbime në familje për të moshuar dhe PAK.
- e) Ofrimi i arsimit falas për fëmijët dhe të rinjtë në situatë rruge.
- f) Shërbim ndërmjetësimi për punësimin e të rinjve pranë strukturave të Bashkisë dhe NjA.
- g) Ofrimi i programeve të formimit profesional pranë NJA dhe në përshtatje me tipologjinë e punësimit në zonat rurale.

Plani Social i Bashkisë Korçë nuk siguron thjesht zbatimin e ligjit, por bëhet garantues dhe mbrojtës i jetës dhe dinjitetit të qytetarëve korçarë, përfitues të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Objektivat afat-mesme te Planit Social 2018 – 2020 te Bashkise Korcë

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: FUQIZIMI I STRUKTURAVE DHE KAPACITETEVE TË SHËRBIMEVE SOCIALE.

Objektivi specifik 1: Fuqizimi i strukturave të DSHSK dhe NJA

Objektivi specifik 1.1: Ngritja e Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe e Referimit të Rasteve (NVR) në çdo NJA dhe Bashki.

- Objektivi specifik 1.2: Fuqizimi i strukturave të NJMF në Bashki dhe NJA.
- Objektivi specifik 1.3: Ngritja e strukturave të supervizimit të shërbimit të mbrojtjes së fëmijëve në bashki.
- Objektivi specifik 1.4: Zhvillimi i mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit.
- Objektivi specifik 2: Rritja e kapaciteteve të stafit
- Objektivi specifik 2.1: Rritja e kapaciteteve të stafit për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- Objektivi specifik 2.2: Zhvillimi i aftësive organizative për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e mbrojtjes së fëmijëve.
- Objektivi specifik 2.3: Zhvillimi i aftësive organizative për buxhetimin e mbrojtjes së fëmijëve.
- Objektivi specifik 2.4: Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në monitorimin/raportimin e çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE EKZISTUESE TË KUJDESIT SHOQËROR DHE NGRITJA E SHËRBIMEVE TË REJA

- Objektivi specifik 1: Përmirësimi i shërbimeve ekzistuese në raport me nevojat e grupeve vulnerabël.
- Objektiv specifik 1.1: Rritja e nivelit të identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.
- Objektiv specifik 1.2: Rritja e informimit institucional e komunitar mbi shërbimet e kujdesit shoqëror dhe të mbrojtjes së fëmijëve.
- Objektiv specifik 1.3: Përmirësimi i situatës dhe cilësisë së shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve.
- Objektivi specifik 2: Zhvillimi i shërbimeve para shoqërore për edukim dhe ndërgjegjësim.
- Objektivi specifik 3: Ngritja e Qendrave Komunitare Multifunkionale në nivel NJA.
- Objektivi specifik 4: Ofrimi i shërbimeve alternative për moshën e tretë.
- Objektivi specifik 5: Ngritja e shërbimeve alternative për personat me AK.
- Objektivi specifik 6: Fuqizimi i shërbimeve për të mbijetuarit e DHF/DHBGJ dhe trafikimit.
- Objektivi specifik 7: Krijimi i shërbimeve me bazë komunitare për personat me varësi nga substancat (alkoli, droga).

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: ZBUTJA DHE LEHTËSIMI I VARFËRISË

- Objektivi specifik 1: Mbështetja dhe fuqizimi i familjeve në nevojë

Strategjia e zbatimit të planit social

Zbatimi i Planit të Shërbimeve Sociale në Bashkinë Korçë do zbatohet nga struktura e DSHSK në bashkëpunim me donatorë dhe OJF që operojnë në territorin e Bashkisë. Monitorimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave të këtij plani do të paraqitet në mënyrë periodike dhe do të jetë pjesë e diskutimeve të strukturave drejtuese, Këshillit Bashkiak dhe partnerëve të tjerë vendorë.

Përgjegjëse për monitorimin e zbatimit e PSHS do të jetë DSHSK-së me sektorët përkatës, e cila në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit do të krijojë një cikël monitorimi dhe vlerësimi sipas afateve të përcaktuara, monitorojë zbatimin e PSHS-së dhe do të hartojë raportet e progresit. DSHSK do mbledhë të dhëna dhe identifikojë boshllëqet në informacionin që nevojitet. Ajo do të ketë gjithashtu rol koordinues dhe bashkërendues mbi ecurinë e zbatimit dhe do të ketë përgjegjësinë e përgatitjes së progres raporteve vjetore. Plani parashikon veprimtari të përmirësimit të sistemit të të dhënave, hartimit të instrumentave të standartizuara të raportimit dhe MV, si dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit me strukturat e nivelit rajonal, qendror dhe OJF-të. Të dhënat administrative do të përdoren nga pjesa më e madhe e institucioneve vendore për të monitoruar pjesëmarrjen e grupeve në nevojë në programet e përgjithshme dhe të synuara të Bashkisë, siç janë shërbimet sociale, programet e ndihmës ekonomike, programet e strehimit, programet e punësimit, programet parandaluese, etj.

Një vëmendje e veçantë në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të PSHS-së do ti kushtohet ngritjes së kapaciteteve të punonjësve të institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për të garantuar mbledhjen e të dhënave të nevojshme duke mbrojtur njëkohësisht të drejtat e privatësisë të grupeve të targetuara. Gjithashtu Bashkia do të koordinojë procesin e mbledhjes së të dhënave nga të gjitha NJA, OJF-të dhe aktorët e tjerë vendor e rajonal të monitorimit dhe vlerësimit të arritjes së objektivave të saj. Bashkia do të lehtësojë gjithashtu koordinimin me organizatat ndërkombëtare, të cilat adresojnë çështjet e grupeve në nevojë përmes programeve të tyre.

Cikli i monitorimit dhe vlerësimit do të përfshijë:

- Vlerësimin formues të progresit dhe rishikimin e veprimeve të parashikuara në mes të afatit, në periudhën 2019-2022.
- Pas vlerësimit formues të progresit, bashkia do të bëjë rishikimin dhe përditësimin e masave të PSHS-së për grupet e targetuara, duke patur parasysh edhe planifikimet buxhetore deri në vitin 2022.
- Një vlerësim përfundimtar që do të bëhet në fund të 2022, ku do të përcaktohet çdo çështje e pazgjidhur dhe zhvillime që mbeten për t'u realizuar.

Për garantimin e zhvillimit dhe zbatimit të objektivave PSHS të Bashkisë Vlorë 2018-2021 (referuar në këtë plan) do të:

- monitorohen treguesit e përcaktuar në plan;
- rekomandohen ndryshime në programet sektoriale, duke pasur parasysh arritjet, rrethanat (kihen parasysh këtu rreziqet) dhe eksperiencat e mëparshme;
- sigurohen konsultime me palët e interesit, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit për publikun;
- jepet kontribut në rritjen e konsistencës dhe integritit të politikave dhe masave të Shërbimeve Sociale në të gjitha nivelet e administrimit, si dhe në përdorimin më të mirë të burimeve.

Baza kryesore e kuadrit monitorues të Planit të Shërbimeve Sociale 2019-2022, do të jenë treguesit e monitorimit të paraqitur për secilin objektiv dhe aktivitet në Planin e Veprimit.

Raportet e M&V do të përgatiten nga vlerësues të jashtëm (grupe ekspertësh apo organizata të

specializuara), për të garantuar një vlerësim më objektiv dhe të paanshëm.

Mënyra e raportimit dhe konsultimit

Instrumenti kryesor në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të PSHS do të jetë Raporti Vjetor i Shërbimeve Sociale, i përgatitur nga DSHSK në Bashkinë e Vlorës. Raporti do të hartohet dhe miratohet brënda tre mujorit të parë të vitit pasardhës të vitit të monitoruar. Ky raport do të:

- Vlerësojë PSHS me fokus progresin e arritur në përmbushjen e masave dhe veprimtarive nga njëra anë dhe e treguesve të monitorimit nga ana tjetër;
- Identifikojë çështje të reja apo ato ndërvepruese, të cilat mund të trajtohen përmes një qasjeje më të koordinuar;
- Raportoje mbi pikëpamjet/këndvështrimet e aktorëve në nivel rajonal dhe lokal.

Raporti do të prezantohet në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit në Bashki dhe Këshillin Bashkiak, me pjesëmarrjen edhe të ofruesve të shërbimeve (OSHC), institucioneve rajonale partnere, si DRSHS, DAR, DRSHP, Grupit të Dialogut Social, apo edhe organizatave partnere ndërkombëtare.

Roli i shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar në zbatimin e Planit të Veprimit

Plani i Veprimit identifikon organet shtetërore që janë përgjegjëse për zbatimin e secilit prej aktiviteteve, por një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve luajnë edhe grupet e tjera të interesit, të cilat lidhin institucionet me grupet në nevojë, si dhe financojnë ndërhyrjet e synuara për përmirësimin e situatës dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. OJF-të që punojnë për përmirësimin e jëtës së grupeve në nevojë dhe ofrojnë shërbime direkte për ta janë identifikuar veçanërisht si partnerë kyç për realizimin e objektivave të PSHS-së. Gjatë periudhës në vijim, bashkia do të vazhdojë të mbështetet në ndihmën për ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve sociale, plotësimin e nevojave për strehim të sigurt, punësim dhe bashkëpunimin në fusha të tjera. Po ashtu, bashkia do të jete pjesë aktive në aktivitetin e Grupit të Dialogut Social ku perfaqesohen ofruesit dhe perfituesit e shërbimeve në Bashkinë e Korçës.

Komuniteti ndërkombëtar do të kontribuojë gjithashtu në zbatimin e PSHS-së duke promovuar shembujt e praktikës së mirë nga Shqipëria dhe Rajoni, si dhe potencialisht duke bashkëfinancuar disa prej aktiviteteve.

Rreziqet për zbatimin e planit

Me gjithë përpjekjet për të hartuar një plan shërbimesh sociale bazuar në nevojat e identifikuar si dhe motivimin e Bashkisë për ta bërë atë të zbatueshëm, duhen marrë në konsideratë edhe disa rreziqe që mund të hasen gjatë këtij procesi. Mospajtimi i ndryshimeve ligjore dhe përgjegjesive të kaluara tek bashkia për sigurimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror që i takojnë grupeve vulnerabël, është një rrezik present që mund të ndikojë negativisht në zbatimin e planit. Rreziku i përsëritur, që përkeqëson cilësinë dhe numrin e shërbimeve për grupet në nevojë, lidhet me pretendimin e burimeve të kufizuara financiare të bashkisë, si dhe me realitetin e burimeve njerëzore të pamjaftueshme të DSHSK-së. Edhe në vlerësimin paraprak të situatës janë theksuar mungesat e stafit të specializuar si në numër dhe në kapacitetet profesionale për t'iu përgjigjur me shërbime të përshtatshme nevojave reale dhe komplekse të grupeve në nevojë. Një rrezik tjetër për zbatimin e planit mund të paraqitet lidhur me ndryshime eventuale në struktura dhe stafe, veçanërisht në periudhat e zgjedhjeve politike vendore dhe qëndrore.

Së fundi, bashkëpunimi i pamjaftueshëm midis institucioneve të niveleve të ndryshme dhe koordinimi i pamjaftueshëm i shërbimeve eventualisht mund të ndikojë në zbatimin e disa aktiviteteve të planit.

Aneks: 1 Plani i Veprimit

PLANI I VEPRIMIT PËR SHËRBIMET SOCIALE - BASHKIA KORÇË

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: FUQIZIMI I STRUKTURAVE DHE KAPACITETEVE TË SHËRBIMEVE SOCIALE							
Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afatet	Treguesit e Monitorimit	Burimet e të dhënave	Financimi		
					Vlerësimi i kostos vjetore në Lek	Burimet e mundshme të financimit	
						Buxheti i BK	Donatorët
Objektivi specifik 1: Fuqizimi i strukturave të DSHSK dhe NJA							
Objektivi specifik 1.1: Ngritja e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe e Referimit të Rasteve (NVRN) në çdo NJA dhe Bashki.							
Krijimi i strukturës së NVRN në Bashki dhe NJA sipas numrit të popullsisë dhe nevojave përshërbime. (sipas ligjit: <i>1punonjës social për 6.000 - 10,000 banorë</i>)	BK DSHSK NJA	2019	1 koordinator i rekrutuar në Bashki përgjegjës për NVRN. 4 punonjës social të rekrutuar, specialist i NVRN në NJA.	Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji i ri i shërbimeve të kujdesit shoqëror.	2.700.000	2.700.000	
Diskutimi dhe miratimi i përshkrimeve të punës të figurave profesionale që do të përbëjnë NJVRN ²	DSHSK NJA	2019	Përshkrimet e punës për të gjithë profesionistët	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji i shërbimeve të kujdesit shoqëror	organizative	organizative	
Aktivite informuese me aktorët relevantë përgjegjës në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror mbi punën e DSHSK në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe detyrimet ligjore e institucionale reciproke në këtë fushë	DSHSK Institucionet përgjegjëse	2019	Numri i institucioneve pjesëmarrëse në raport me numrin e institucioneve përgjegjëse sipas ligjit	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji i shërbimeve të kujdesit shoqëror	30.000	30.000	

Objektivi specifik 1.2: Fuqizimi i strukturave të NJMF-së në Bashki dhe NJA.							
Ngritja e strukturës së NJMF-së/rekrutimi i PFM-ve në cdo NJA <i>(1 PMF për cdo NJA - të pangarkuar me role të tjera)</i> ³	DSHSK	2019-2022	Numri i PMF të rekrutuar në raport me numrin e fëmijëve në zonë (sipas ligjit).	Legjislacioni Përkatës në fuqi Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"	3.360.000	3.360.000	-
Diskutimi dhe miratimi i përkrahjeve të punës të PMF-së në bashki/NJA <i>(sipas modelit të propozuar nga ASHMDF).</i>	DSHSK	2019	Përkrahimi i punës i miratuar për PMF në bashki dhe NJA	Legjislacioni Përkatës në fuqi Ligji "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e fëmijëve" Modeli ASHMDF	organizative	organizative	-
Funksionimi i rregullt i grupit ndërsektorial ad hoc, në nivel drejtuesish të institucioneve vendore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve <i>(grupi ad hoc takohet të paktën 1 herë në 4 muaj)</i>	DSHSK Institucionet përgjegjëse, pjesë e grupit ad hoc	2019- 2022	Numri i drejtuesve pjesëmarrës në grup në raport me numrin e drejtuesve të institucioneve përgjegjëse Numri vjetor i takimeve të grupit në raport me numrin e takimeve të kërkuara (min. 3)	Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"	organizative	organizative	-

Objektivi specifik 1.3: Ngritja e strukturave të supervizimit të shërbimit të mbrojtjes së fëmijëve në bashki							
Vlerësimi i nevojave dhe planifikimi i supervizimit në strukturat e mbrojtjes së fëmijëve	DSHSK	2019 - 2022	Dokumenti i planifikimit të supervizimit Marrëveshja vjetore e supervizimit për cdo PMF	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve" Udhëzimet e ASHMDF	organizative	organizative	
Zbatimi i procedurave të supervizimit dhe roleve e përgjegjëse të supervizuesit e të supervizuarit <i>(sipas udhëzimeve të ASHMDF)</i>	DSHSK	2019 - 2022	Numri i takimeve të supervizimit të realizuara në raport me numrin e takimeve të planifikuara në marrëveshjen vjetore	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve" Udhëzimet e ASHMDF	organizative	organizative	

² Këto figura profesionale përfshijnë punonjës social, punonjës në mbrojtje të fëmijëve, nëpunës gjinor, administratorin shoqëror, etj.

³ Sipas Ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", numri i PMF-ve në NJA përcaktohet referuar numrit të fëmijëve që duhet të mbulojë secili (1 PMF për 3000 fëmijë).

Objektivi specifik 1.4: Fuqizimi i strukturave të barazisë gjinorë dhe DHF ne Bashki dhe NJA.							
Ngritja e strukturës së BGJ dhe DHF- së/rekrutimi i NGJ në bashki/NJA	DSHSK NJA	2019-2022	Numri i NGJ të rekrutuar në strukturat e bashkisë dhe NJA.	Ligji për BGJ dhe DHF	3.360.000	3.360.000	-
Diskutimi dhe miratimi i përshkrimeve të punës të NGJ në bashki/NJA	DSHSK NJA	2019	Përshkrimi i punës i miratuar për NGJ në bashki dhe NJA	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji për BGJ dhe DHF	organizative	organizative	-

Objektivi specifik 1.5: Zhvillimi i mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit.							
Përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror të prokuruar, sipas kuadrit rregullator.	Agjencia e prokurimeve publike BK DSHSK Ofruesit e shërbimeve	2019	Dokumenti i procedurave	Ligji i shërbimeve të kujdesit shoqëror	organizative	organizative	-
Përcaktimi i kriterëve, procedurave dhe përgjegjësi për zbatimin dhe monitorimin e Fondit Social.	MSHKS, BK DSHSK	2019	Dokumenti i procedurave	Ligji i shërbimeve të kujdesit shoqëror	organizative	organizative	-

Objektivi specifik 2: Rritja e kapaciteteve të stafit							
Objektivi specifik 2.1: Rritja e kapaciteteve të stafit për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror							
Trajnim mbishportën e shërbimeve sociale.	DSHSK OJF	2019-2022	Moduli i trajnimit, Numri i stafit të trajnuar në raport me numrin e stafit që ka nevojë për trajnim	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji I shërbimeve të kujdesit shoqëror Dokumente të praktikave të mira Dokumenti i modelit pilot	30.000	-	-
Trajnim mbi kriteret e perfitimit dhe zbatimin dhe monitorimin e Fondit Social	DSHSK SHSSH OJF	2019-2022	Moduli i trajnimit Numri i stafit të trajnuar në raport me numrin e stafit që ka nevojë për trajnim	Ligji i shërbimeve të kujdesit shoqëror	30.000	-	-

⁴ "Fëmijë në nevojë për mbrojtje" është personi nën moshën 18 vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individi nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer një veprë penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin. Në këtë kategori do të përfshihen dhe fëmijët në situatë rruge, fëmijë viktimë trafikimi, viktimë të mundshme trafikimi.

Objektivi specifik 2.2: Zhvillimi i aftësive organizative për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e mbrojtjes së fëmijëve.							
Përmirësimi nga çdo NJMF i bazës së të dhënave mbi fëmijët në nevojë për mbrojtje.	DSHSK NJA	2019-2022	Baza e të dhënave e ndërtuar; Baza e të dhënave e përditësuar me situatat e fundit të rasteve të fëmijëve; Numri i institucioneve që japin informacion mbi situatën e fëmijëve në nevojë për mbrojtje në raport me numrin e institucioneve përgjegjëse në zonë.	Legjislacioni përkatës në fuqi	organizative	organizative	-
Mbledhja/përmirësimi i të dhënave sasiore dhe procesimi i tyre dhe i informacionit për situatën e mbrojtjes së fëmijëve.	DSHSK NJA	2019 - 2022	Të dhënat sasiore mblidhen sipas kërkesave tëASHMDF	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” NJA ASHMDF	organizative	organizative	-
Analiza periodike multisektoriale e situatës së mbrojtjes së fëmijëve, bazuar mbi rastet në nevojë për mbrojtje.	DSHSK NJA	2019 - 2022	Dokumenti i raportit vjetor të analizës periodike multisektoriale	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” NJA ASHMDF	organizative	organizative	-

Objektivi specifik 2.3: Zhvillimi i aftësive organizative për buxhetimin e mbrojtjes së fëmijëve.							
Analizë e kostos së zbatimit të planit social për mbrojtjen e fëmijëve.	DSHSK BK	2019-2022	Kostimi i planit katërvjeçar Kostimi vjetor i planit	DSHSK NJA	organizative	organizative	-
Hartimi i planbuxheteve vjetore për zbatimin e planit të mbrojtjes së fëmijëve.	DSHSK BK	2019-2022	Dokumenti i planbuxhetit bazuar në kostimin vjetor të planit	DSHSK NJA	organizative	organizative	-

Buxhetimi vjetor i shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, bazuar në numrin e fëmijëve për nevojë për mbrojtje gjatë vitit paraardhës dhe/ose nevojat e identifikuarat përgjatë tij (sipas udhëzimeve të MSHKS)	DSHSK BK	2019-2022	Buxhetimi i vitit pasardhës sipas udhëzimeve të MSHKS	DSHSK NJ	organizative	organizative	-
---	-------------	-----------	---	-------------	--------------	--------------	---

Objektivi specifik 2.4: Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në monitorimin/raportimin e çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve.

Ngritja e mekanizmave që sigurojnë pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje lidhur me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, në nivel bashkie	DSHSK NJ	2019-2022	Mekanizmat për pjesëmarrjen e fëmijëve janë të ngritur dhe funksionale Numri i rekomandimeve të dhëna nga fëmijët për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve që janë Reflektuar në vendimmarrjen në nivel bashkie	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Përtë drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Dokumente të praktikave të mira	organizative	organizative	-
Konsultimi i fëmijëve lidhur me programe/nisma të ndryshmetë bashkisë lidhur me mbrojtjen e fëmijëve	DSHSK NJ	2019-2022	Numri i fëmijëve të konsultuar sipas grupmoshës, seksit, etnisë, AK, etj në raport me numrin e fëmijëve sipas këtyre grupeve dhe numrin total të fëmijëve në zonë	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Përtë drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Dokumente të praktikave të mira	organizative	organizative	-

Objektivi specifik 1: Përmirësimi i shërbimeve ekzistuese për fëmijët në përshtatje me nevojat e tyre.

Objektiv specifik 1.1: Rritja e nivelit të identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Prezantimi dhe vënia në dispozicion të të gjithë profesionistëve/institucioneve përgjegjëse i të gjitha formave të dokumentimit për identifikimin dhe raportimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe me detyrimet ligjore përkatëse	DSHSK	2019-2022	Numri i formave të shpërndara në raport me Numrin e formave Ekzistuese të dokumentimit sipas ligjit Numri i formave të shpërndara në raport me numrin e institucioneve përgjegjëse (elektronikisht ose në formë të printuar) Çdo dosje e PMF për një fëmije në situatë për mbrojtje përmban të gjitha format e mësipërme të plotësuar	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”	organizative	organizative	-
--	-------	-----------	---	--	--------------	--------------	---

Ngritja e skuadrave të lëvizshme, në bashkëpunim me partnerët dhe skuadrat e shërbimeve për identifikimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje që kërkojnë identifikim proaktiv. (fëmijët në situatë rruge, të shfrytëzuar ekonomisht, fëmijët në rrezik për trafikim/viktima të trafikimit, etj)	DSHSK OJF	2019-2022	Numri i skuadrave të ngritura në raport me numrin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje që kërkojnë identifikim proaktiv përgjatë vitit të mëparshëm	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”	organizative	organizative	-
--	------------------	-----------	---	--	--------------	--------------	---

Krijimi i bazës logjistike të nevojshme për Lëvizshmërinë dhe proaktiviteti e strukturave përgjegjëse për realizimin e identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje (sigurimi i mjeteve të transportit dhe komunikimit)	DSHSK	2019-2022	Numri i mjeteve të transportit dhe sasia e karburantit në dispozicion në raport me nevojën për identifikim të rasteve (zona e mbulimit, numri i fëmijëve në nevojë); Mjetet e komunikimit në dispozicion (telefon, kartë, numër telefoni me kontratë), në raport me nevojën për komunikim	Legjislacioni Përkatës në fuqi Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”	2.000.000	2.000.000	-
--	-------	-----------	--	--	-----------	-----------	---

Afishimi i dukshëm i numrave të kontaktit për raportimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje në të gjitha institucionet relevante publike dhe jopublike dhe mjediset komunitare	DSHSK NJA	2019-2022	Numri i afishimeve të dukshme në raport me numrin e institucioneve relevante publike dhe jopublike Numri i afishimeve të dukshme në raport me numrin e mjedisve komunitare në zonë	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”	15.000	15.000	-
--	--------------	-----------	---	--	--------	--------	---

Objektiv specifik 1.2: Rritja e informimit institucional e komunitar mbi shërbimet e kujdesit shoqëror dhe të mbrojtjes së fëmijëve.							
Afishimi i detyrimeve të institucioneve për raportimin e dhunës ndaj fëmijës në çdo institucion përgjegjës, publik ose jopublik	DSHSK	2019-2022	Numri i afishimeve në raport me numrin e institucioneve relevante publike dhe jopublike		10.000	10.000	-
Krijimi i seksionit të legjislacionit të përditësuar të mbrojtjes së fëmijëve në faqet zyrtare të çdo institucioni përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve dhe seksioni në bashki(inst. qendrore dhe vendore) sidomos të procedurave, afateve të veprimit në mbrojtje të fëmijëve	DSHSK Institucionet përgjegjëse	2019	Legjislacioni i mbrojtjes së fëmijëve është i publikuar në faqen zyrtare të çdo institucioni përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve dhe është i përditësuar		30.000	30.000	-

Përgatitja dhe shpërndarja e broshurave informuese mbi shërbimet ekzistuese dhe të reja për kujdesin shoqëror dhe mbrojtjen e fëmijëve, autoritetet përgjegjëse dhe të drejtat e qytetarëve për shërbime dhe të drejtat e fëmijëve për mbrojtje (në bashki, NJA, mjedise publike, institucione publike dhe OJF përkatëse, etj)	DSHSK NJA	2019-2022	Numri i shërbimeve ekzistuese dhe të reja, autoriteteve përgjegjëse dhe të drejtave të fëmijëve për mbrojtje të përfshira në broshura në raport me numrin e tyre sipas ligjit Numri i materialeve informuese të shpërndara në raport me numrin e prindërve/fëmijëve/qyte tarëve në zonë		15.000	15.000	-
--	--------------	-----------	--	--	--------	--------	---

Objektiv specifik 1.3: Përmirësimi i situatës dhe cilësisë së shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve.							
Ofrimi i shërbimit 24 orësh për përgjigjen ndaj nevojave emergjente të fëmijëve në nevojë për mbrojtje ⁵ ,	DSHSK	2019	Shërbimi 24-orësh është i ngritur dhe funksional; Numri i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje që kanë marrë përgjigje menjëherë me momentin e prezantimit të nevojës në raport me numrin e rasteve të fëmijëve me nevojave emergjente.	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”	organizative	organizative	-
Ngritja e qendrave shumëfunksionale në nivel bashkie dhe NJA Kostoja e llogaritur parashikon rrogat e stafit, pagesat e uje, drita, ngrohje, materiale didaktike per 60 femije. Nuk jane parashikuar kostot e ndertimit apo rikonstruksionit qe mund te variojne nga 3.720.000 ne 7.440.000 Leke	MSSHÇS BK /DSHSK NJA OJF	2019 – 2022	Dokumenti i modelit te sherbimit (pershkrimi i shkurter ne Aneks) 60 femije perfitues 6 staf (5 te specializuar dhe 1 ndihmes)	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji për shërbimet e kujdesit shoqëror	4.890.000	4.890.000	-
Ngritja dhe funksionimi i vazhdueshëm i qendrës së emergjencës/pritëse për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje (24/7 me kapacitet 2-4 shtretër) <i>(brenda hapësirave të qendrave komunitare publike, institucioneve të tjera publike vendore, OJF-ve bashkëpunuese, sa herë që është e mundur, apo në mungesë të sigurimit të tyre, përmes marrëveshjeve me ofrues jopublikë të shërbimeve).</i>	DSHSK OJF	2019	Dokumenti i modelit të shërbimit Kostimi i ngritjes dhe ofrimit të shërbimit 4 persona staf 3 dhoma + 1 banje (2 akomodim + 1 per punonjesin social)	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji për shërbimet e kujdesit shoqëror	2.208.000	2.208.000	-

<p>Krijimi i bazës logjistike të nevojshme për strukturat përgjegjëse për realizimin me efektivitet të menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje (<i>sigurimi i hapësirave – zyrë, pajisje, si kompjuter, printer, etj., dhe i mjeteve të transportit dhe komunikimit</i>).</p> <p><i>Kostoja perfshin: 1 automjet; 1 kompjuter dhe 1 printer; si dhe 1 numer telefoni para-paguar</i></p>	<p>DSHSK NJA</p>	<p>2019-2021</p>	<p>Zyra e PMF përmban pajisje zyre-kompjuter, printer, mjedis miqësor për fëmijët, telefon, transport Numri i mjeteve të transportit dhe sasia e karburantit në dispozicion në raport me nevojën për identifikim të rasteve (zona e mbulimit, numri i fëmijëve në nevojë); Mjetet e komunikimit në dispozicion (telefon, kartë, numër telefoni me kontratë), në raport me nevojën përkomunikim</p>	<p>Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve</p>	<p>2.200.000</p>	<p>2.200.000</p>	
<p>Hartimi dhe zbatimi i PIM6 për çdo fëmijë të identifikuar si në nevojë për mbrojtje.</p>	<p>DSHSK NJA</p>	<p>2019-2021</p>	<p>Numri i PIM të hartuar dhe zbatuar në raport me numrin e fëmijëve të identifikuar si në nevojë për mbrojtje</p>	<p>Legjislacioni përkatës në fuqi; Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.</p>	<p>organizative</p>	<p>organizative</p>	
<p>Sigurimi i pjesëmarrjes së fëmijës dhe familjes përgjatë çdo hapi të procesit të menaxhimit të rastit (që nga identifikimi/raportimi deri tek mbyllja e rastit).</p>	<p>DSHSK NJA</p>	<p>2019-2021</p>	<p>Numri i takimeve me pjesëmarrje të dokumentuar të fëmijës dhe familjes në raport me numrin e takimeve të realizuar për menaxhimin e rastit ku pjesëmarrja e tyre është e detyrueshme sipas ligjit</p>	<p>Legjislacioni përkatës në fuqi. Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.</p>	<p>organizative</p>	<p>Organizative</p>	

Ofrimi i shërbimeve të mbështetjes psiko - emocionale për çdo fëmijë në nevojë për mbrojtje (përmes punonjësve të qendrave komunitare publike, të OJF-ve bashkëpunuese, sa herë që është e mundur, apo në mungesë të sigurimit të tyre, përmes marrëveshjeve me ofrues privatë të shërbimeve).	DSHSK / NJMF OJF	2019-2020	Dokumenti i modelit të shërbimit; Kostimi i ofrimit të shërbimit; 3 fëmijë përfitues në ditë.	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve	organizative	organizative	
Përmirësimi i infrastrukturës së bashkisë për të krijuar mjedise miqësore (veçanërisht konfidenciale) për fëmijët	DSHSK		Numri i mjediseve/hapësirave të kthyer në mjedise miqësore për fëmijët në raport me numrin e mjediseve/hapësirave që kanë nevojë për këtë përmirësim; Takimet me fëmijët realizohen me dyer të mbyllura në mjedise konfidenciale; Në takimet me fëmijët marrin pjesë vetëm personat relevantë sipas ligjit.	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”	-	-	-
Shpërndarja në institucionet relevante e adresarit të shërbimeve/projekteve vendore në fushën e mbrojtjes së fëmijëve (dhe/ose publikimi online).	DSHSK NJA	2018-2020	Numri i adresarëve të shpërndarë në raport me numrin e institucioneve relevante; Publikimi online i adresarit (nëse ka).	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”	10.000	10.000	-

⁵ Bashkia duhet të sigurojë disponueshmërinë, si të punonjësit, ashtu edhe të logjistikës së nevojshme (zyrë, transport, komunikim) për t’u përgjigjur nevojave emergjente për mbrojtje në çdo çast përgjatë 24 orëve.

⁶ Plani individual i mbrojtjes.

<p>Forcimi i shërbimit të Kujdestarisë duke përfshirë: fuqizimin e strukturës së kujdestarisë në bashki, identifikimin e familjeve kujdestare duke përfshirë edhe familje pa lidhje gjaku, trajnimin e familjeve kujdestare, promovimin e shërbimit të kujdestarisë, mbështetjen e familjeve kujdestare.</p>	<p>DSHSK NJA</p>	<p>2019 - 2021</p>	<p>Ekipi i ngritur dhe funksional; Plan për monitorimin e shërbimit; Dokumenti për Komisionin e kujdestarisë; Numri i familjeve të trajnuara në raport me numrin e fëmijëve që kanë nevojë për këtë shërbim; Numri i fëmijëve të vendosur në familje kujdestare pa lidhje gjaku në raport me numrin e fëmijëve që kanë nevojë për këtë shërbim; Numri i vendimeve të gjykatës në përputhje me vlerësimet e strukturës së kujdestarisë në bashki; Numri i raporteve të monitorimit të familjeve kujdestare në raport me numrin e raporteve të detyrueshme për çdo familje.</p>	<p>Legjislacioni përkatës në fuqi Ligi "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"</p>	<p>organizative</p>	<p>organizative</p>	
--	----------------------	--------------------	---	--	---------------------	---------------------	--

<p>Objektivi specifik 2: Zhvillimi i shërbimeve para shoqërore për edukim dhe ndërgjegjësim.</p>							
<p>Ofrimi i programeve të prindërimit të shëndetshëm, menaxhimi i zemërimit për dhunuesit, fuqizimi i viktimave të dhunës në familje, trafikimit, etj).</p>	<p>DSHSK NJA OJF</p>	<p>2019-2022</p>	<p>Numri i përfituesve në raport me numrin e individëve/ familjeve në nevojë për këtë shërbim; Kategoritë e shërbimeve dhe programeve të ngritura në raport me ligjin; Numri i stafit për përfitues në raport me ligjin; Burimet e alokuara në raport me numrin e individëve /familjeve në nevojë për këtë shërbim</p>		<p>organizative</p>	<p>organizative</p>	

Objektivi specifik 3: Ngritja e Qendrave Komunitare Multifunkionale në nivel NJA.							
Zhvillimi dhe miratimi i koncept modelit të menaxhimit të QKM-ve	DSHSK	2019	Rregullorja e brendshme VKB	Legjislacioni përkatës në fuqi	organizative	organizative	-
Zhvillimi i strukturës së stafit	DSHSK DBNJ NJA	2019	Organigrama	Legjislacioni përkatës në fuqi VKB	organizative	organizative	-
Krijimi i protokolleve operative të QKM-ve	DSHSK	2019	Dokumenti i protokolleve	Legjislacioni përkatës në fuqi Partnerë vendor Publikë dhe jopublikë	organizative	organizative	-

Objektivi specifik 4: Ofrimi i shërbimeve alternative për moshën e tretë.							
Vënia në funksion e 1 qendrave ditore për moshën e tretë në Korçe.	DSHSK OJF	2019-2022	Kostimi i ngritjes dhe ofrimit të shërbimit; Numri i stafit në raport me numrin e përfituesve; Numri i përfituesve në raport me numrin e individëve/familjeve në nevojë për këtë shërbim; Kategoritë e shërbimeve dhe programeve të ngritura në raport me ligjin; Burimet e alokuara në raport me numrin e individëve/familjeve në nevojë për këtë shërbim	Legjislacioni në fuqi	-	-	-
Ofrimi i shërbimeve të kujdesit në shtëpi për të moshuarit e vetmuar.	DSHSK NJA OJF	2019-2022	Dokumenti modelit pilot për të moshuar; Kostimi i ngritjes dhe ofrimit të shërbimit; Numri i përfituesve në raport me numrin e individëve/familjeve në nevojë për këtë shërbim; Kategoritë e shërbimeve dhe programeve të ngritura në raport me ligjin; Numri i stafit për përfitues në raport me ligjin; Burimet e alokuara në raport me numrin e individëve/ familjeve në nevojë për këtë shërbim.	DSHSK NJA	organizative	organizative	-

Objekti 5: Ngritja e shërbimeve alternative për personat me AK.							
<p>Ngritja e një qendre të kujdesit ditor për personat me probleme të shëndetit mendor.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Miratimi i modelit të shërbimit dhe kostimi; - Vënia në funksionim e shërbimit. 	<p>DSHSK</p> <p>Spitali Korçë</p> <p>OJF të specializuara</p>	2020-2022	<p>Dokumenti i modelit për shëndetin mendor; Kostimi i ngritjes dhe ofrimit të shërbimit; Numri i përfituesve në raport me numrin e individëve/familjeve në nevojë për këtë shërbim; Kategoritë e shërbimeve dhe programeve të ngritura në raport me ligjin; Numri i stafit për përfitues në raport me ligjin; Burimet e alokuara në raport me numrin e individëve/familjeve në nevojë për këtë shërbim.</p>		Shtator 2019	-	-
<p>Ofrimi i shërbimeve të kujdesit në familje për PAK.</p>	<p>DSHSK</p> <p>NJA</p> <p>OJF të specializuara</p>	2019-2021	<p>Dokumentii modelit për personat PAK; Kostimi i ngritjes dhe ofrimit të shërbimit; Numri i përfituesve në raport me numrin e individëve/familjeve në nevojë për këtë shërbim; Kategoritë e shërbimeve dhe programeve të ngritura në raport me ligjin; Numri i stafit për përfitues në raport me ligjin; Burimet e alokuara në raport me numrin e individëve/ familjeve në nevojë për këtë shërbim</p>	<p>DSHSK</p> <p>NJA</p>	organizative	organizative	-
<p>Përmirësimi i ambienteve publike të aksesueshme për personat me AK</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i situatës së aksesueshmërisë për AK në të gjitha institucionet publike dhe jo publike në Bashkinë Korçë, me qëllim identifikimin e barrierave dhe kostimin e ndërhyrjeve që duhet të kryhen në infrastrukturë. • Investime prioritare në shkollat publike në territorin e Bashkisë Korçë, në përputhje me nevojat e identifikuar nga vlerësimi i kryer. 	<p>DSHSK</p> <p>OJF për mbrojtjen e të drejtave të PAK</p>	2019-2021	<p>Raporti i vlerësimit identifikon qartësisht godinat dhe mjediset ku duhet të ndërhyhet për ti bërë të aksesueshme.</p> <p>Investime të ndërmarrë nga Bashkia apo sugjeruar aktorëve të tjerë publik me qëllim garantimin e aksesit të personave me aftësi të kufizuara në mjediset dhe institucione publike.</p>	<p>Ligji "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"</p>	shtator 2019	-	-

Objektivi specific 6: Fuqizimi i shërbimeve për të mbijetuarit e DHF/DHBGJ dhe trafikimit.							
Ofrimi i shërbimeve të mbështetjes psiko- sociale (këshillim) dhe asistencës ligjore falas për të mbijetuarit e DHF/DHBGJ dhe trafikimit.	DSHS NJA OJF	2019-2022	Numri i të mbijetuarve të trajtuar në raport me numrin e përgjithshëm. Numri seancave të këshillimit	Legjislacioni në fuqi	organizative	Organizative	-
Ngritja e qendrës së emergjencës për rastet e DHF dhe DHBGJ: - Miratimi i modelit të shërbimit dhe kostimi; - Vënia në funksionim e shërbimit.	DSHSK MSHMS OJF	2019-2022	DSHS Kostimi i ngritjes dhe ofrimit të shërbimit 4 përfitues gjithësej 6 persona staf gjithësej	Legjislacioni në fuqi	organizative	organizative	

Objektivi specific 7: Krijimi i shërbimeve me bazë komunitare për personat me varësi nga substancat (alkoli, droga).							
Ngritja e një Qendre të kujdesit ditor për personat me varësi nga substancat: - Miratimi i modelit të shërbimit dhe kostimi; - Vënia në funksionim e shërbimit.	DSHSK MSHMS OJF të specializuara	2020-2022	Kostimi i ngritjes dhe ofrimit të shërbimit Numri i stafit të specializuar në raport me përfituesit e asistuar Numri përfituesve	DRSHP OJF DSHSK	Shtator 2019	-	-

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: ZBUTJA DHE LEHTËSIMI I VARFËRISË

Objektivi 1: Mbështetja dhe fuqizimi i familjeve në nevojë							
Identifikimi i familjeve aplikante, të cilat nuk përfitojnë nga skema e NE, referim dhe bashkëpunim me Këshillin Bashkiak për miratimin e kriterëve.	DSHSK Administratorët shoqërorë /NJA	2019-2022	Numri i familjeve të identifikuar.	DSHSK	organizative	organizative	-
Mbështetja emergjente për nevojat bazë materiale të familjeve në nevojë	DSHSK OJF	2019-2022	Numri i familjeve të mbështetura në raport me numrin e familjeve në nevojë për mbështetje	DSHSK	sipas vleresimit	sipas vleresimit	sipas vleresimit
Identifikimi dhe referimi për ndërmjetësim punësimi për kategoritë në nevojë (familjet përfituese të NE, gratë kryefamiljare dhe të rinjtë, vecanërisht të rinjtë Romë dhe Egjiptianë).	DSHSK NJA	2019-2022	Numri i personave të punësuar në raport me numrin e personave në nevojë për punësim	DSHSK	organizative	organizative	-

Ngritja e shërbimeve të reja ditore falas për fëmijë (çerdhe) duke vlerësuar nevojat dhe duke priorizuar zonat me varfëri dhe papunësi të lartë.	DSHSK NJA BK	2019-2022	Kapaciteti/numri i fëmijëve i çerdheve të ngritura /rehabilituara në raport me numrin e fëmijëve në nevojë për këtë shërbim Kapaciteti/numri i fëmijëve i kopshteve të ngritura /rehabilituara në raport me numrin e fëmijëve në nevojë për këtë shërbim	DSHSK	-	-	-
Alokimi i kuotave për në kopshte dhe çerdhe për fëmijët në nevojë për mbrojtje (fëmijë në situatë rruge në veçanti), të paktën 5%.	DSHSK BK	2019-2022	VKB për alokimin e kuotave Numri i fëmijëve që përfitojnë nga kuotat në raport me numrin e fëmijëve në nevojë për këtë shërbim	DSHSK	organizative	organizative	-
Strehimi i familjeve në nevojë në banesa sociale ose përfitimi nga programet e strehimit social (me prioritet gratë kryefamiljare, viktimat e DHF dhe DHBGJ) Dhënia e paketave ushqimore dhe higjienike për fëmijët e varfër, të kequshqyer (në familje që përfitojnë ose jo NE)	DSHSK BK	2019-2022	Numri i fëmijëve të pastrehë që futen në banesa sociale/shtëpi të rehabilituara në raport me numrin e fëmijëve që kanë nevojë për këto banesa; Numri i fëmijëve të mbështetur me paketa ushqimore dhe higjienike në raport me numrin e fëmijëve që kanë nevojë për këto paketa, në mënyrë periodike Procesi i ndarjes së paketave drejtohet nga PMF	DSHSK	-	-	-

Aneks 2 SHËRBIMET SHOQËRORE EKZISTUESE NË BASHKINË E KORÇËS

Nr.	EMRI I SHËRBIMIT	PËR CILIN TARGET GROUP	ÇFARË SHËRBIMESH OFRON (PËRMBLEDHJE)	KUSH E OFRON SI SHËRBIM	VITI I FILLIMIT TË VEPRIMTARISË NE TERRITORIN E BASHKISË KORÇË
1	Shtëpia e Foshnjës	Fëmijët	Qendër Rezidenciale me të gjitha shërbimet	Bashkia Korçë dhe MSHMS	1947
2	Qendra Ditore Komunitare për të rinj me AK nga 18-35vjet "Atelie"	Të rinj me handikap mendor, shqisor, probleme të moderuara të zhvillimit	Përkujdes shëndetësor dhe higijeno-sanitar Ushqyerje (dreka) Elementë të mësimi special Terapi edukative, individuale dhe në grup Integrim social në komunitet Aktivitete krijuese artistike Transport falas nga shtëpia në Qendër anasjelltas	Bashkia Korçë dhe MSHMS	2002
3	Shkolla Speciale për fëmijët me AK.	Personat 6-19 vjec dhe familjet e tyre	Vlerësimi dhe ngritja e programeve edukative individuale për fëmijët e shkollave dhe kopshteve; Terapi individuale dhe në grup për fëmijët me AK në fushat e zhvillimit, konjcionit, motorikës fine dhe globale dhe autonomisë personale, logopedi, menaxhim sjelljes, terapi okupacionale, socializim, metoden "Heart" dhe "Portage"; Mbështetja dhe ngritja e kapaciteteve të prindërve për të advokuar dhe lobuar për të drejtat e fëmijëve të tyre; Ndërgjegjësimi i komunitetit për të mbështetur gjithëpërfshirjen e fëmijëve në fusha të caktuara të jetës	Bashkia Korçë dhe MSHMS	1994
4	Qendra Kulturore për Fëmijë. Së shpejti kjo Qendër do të transerohet brenda kompleksit të ri të sportit, tek "Qyteti I Fëmijëve"	Fëmijët	Aktivitete artistike, sportive dhe shkencore për edukimin, kultivimin dhe zhvillimin e talenteve, prirjeve dhe dhuntive të fëmijëve pas procesit mësimor, duke u bërë kështu një fidanishte e talenteve në të gjitha fushat e jetës; Koordinon dhe organizon veprimtaritë kulturore, artistike, sportive e shkencore të shkollave 9-vjecare.	Bashkia Korçë	1946
5	World Vision	Fëmijët deri në 18 vjec,	Mbrojtja e fëmijëve	World Vision	1999

		familjet e tyre	Rritja e kapacitetit të fëmijëve për të njohur dhe advokuar për të drejtat e tyre; Ndërmarrja e iniciativave për zgjidhjen e problematikave në zonën e tyre. Të rinjtë Ndërgjegjësimi dhe rritja e kapaciteteve për t'u përfshirë në jetën sociale; Rritja e ndërgjegjësimit qytetar dhe advokimi për mbrojtjen e të drejtave të tyre.		
6	Observatori i të drejtave të fëmijëve	Fëmijët nga 1-18 vjeç	Observatori monitoron situatën e të drejtave të fëmijëve nga niveli lokal në atë qendror.	Observatori i të drejt.femijev	2009
7	Fondacioni Dorcas Aid Internacional (DAI) dhe Misoni Emanuel	Grupet vulnerabël	Zbutja e varfërisë nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm; Sigurimi i ndihmave të emergjencës në zona ku ndodhin katastrofa natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga dora e njeriut, si pjesë ose kombinim i programeve të rehabilitimit dhe bashkërendimit; Ofrimi i ndihmës sociale njerëzve më të varfër. Pjesëmarrja dhe fuqizimi i përfituesve; Çështjet gjinore; Lobimi & Advokacia.	Fondacioni Dorcas Aid Internacional (DAI) dhe Misoni Emanuel ne bashkëpunim me Bashkinë Korçë	1991
8	Fondacioni Kenedi	Të sëmuret, të moshuarit, të rinjtë djemtë, vajzat, fëmijët e abuzuar, të burgosurit, gratë e dhunuara	Klinikë për të sëmuret dhe të paaftët fizikë Edukimi për fëmijët me aftësi të kufizuara Informimi i vajzave Shtëpi e sigurt për vajzat (Fëmijët e abuzuar dhe risk abuzimi, trafikimi) Qendra e Ditë të Fëmijëve, shërbime pas shkolle për fëmijët vulnerabël, një vakt ushqimor, shërbim higjieno sanitare, aktivitete informuese, edukuese dhe argëtuese për fëmijët e sishemmit 9-vjeçar Sport për djemtë, aktivitete sportive për të rinjtë Vila Kenedi, shtëpi e të moshuarve Përkujdesja në shtëpi, përkujdesje për të moshuarit e vetmuar, shërbime në banesë, pastrim banese, shërbime higjieno-sanitare, vakte ushqimore Projekt për familjet e personave të burgosur Ndihmë për gratë e dhunuara, këshillim.	Fondacioni KENEDI në bashkëpunim me Bashkinë Korçë	1908 dhe rihapet 1990
9	Agjencia Rajonale e	Grupet e biznesit	Mbështet zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të rajonit të	Agjencia Rajonale e	1998

	Zhvillimit (SME), Korçë		Korçës Përgatitja e planeve të biznesit dhe studimeve të fizibilitetit për sektorin privat dhe publik. Zhvillim i sondazheve të marketingut dhe strategjitë e marketingut. Mbështetja e zhvillimeve të resurseve njerëzore për sektorin privat dhe atë publik. Zhvillim dhe zbatim i partneritetet publike-private. Inkurajimi i bashkëpunimin ndërkufitar.	Zhvillimit (SME), Korçë në bashkëpunim me Bashkinë Korçë	
10	Qendra Rinore Korçë Qendra e re tek ish-Shtëpia e Ushtarakave	Të rinjtë 14-18 vjec	Qendra ndërmerr dhe mbështet zhvillimin e politikave rinore. Mbron vlerat dhe dinjitetin njerëzor duke promovuar dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Synon integrimin social të grupeve më vulnerabël duke i kushtuar vëmendje problematikave që shqetësojnë të miturit, të rinjtë dhe PAK. Promovon iniciativat rinore në cdofushë.	Bashkia Korçë dhe MSHMS	2016
11	Srehëz emergjence për gratë e dhunuara	Gratë dhe vajzat, viktimat të trafikimit dhe dhunës në familje	Strehim emergjence 48-ore, përviktimate DHF; Mbështetje për rastet e grave të dhunuara; Shërbim psiko-social	Bashkia Korçë dhe “Jezu Krishti për Ballkanin”	1997
12	Shoqata e Invalidëve të Punës, Dega Korçë	Invalidët e punës Grup invalidesh, të rritur, prindër, me aftësi të kufizuara fizike ose mendore.	Mbrojtja e të drejtave të individëve që janë bërë të paafte në punë të aksidentuar, apo me sëmundje profesionale, apo sëmundje të përgjithshme, por kanë qenë të siguruar dhe kanë paguar kontribut për sigurimet shoqërore. Perfaqësimi i invalidëve që përfitojnë pension invaliditeti nga sistemi i sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë. Zhvillon avokasi, permirsim legjislativ, pajisja e invalidëve të punës me librezën e statusit që përjashton këtë kategori në bazë të legjislativit nga disa detyrime taksore si dhe udhëtim me urban qyteti falas në bashkëpunim me Bashkinë Korçë.	Shoqata Kombëtare e Invalidëve të Punës, Dega Korçë	1991
13	Shoqata Qendistaret	Kategori të ndryshme në varësi të projekteve	Ndihmon gratë dhe fëmijet në nevojë të komunitetit rom dhe atij egjiptjan nepermjet fuqizimit ekonomik duke i thënë kështu stop lypjes dhe trafikimit të fëmijëve”. Projekte që kanë në fokus gruan dhe fëmijën me qëllim minimizimin e braktisjes së shkollës dhe fuqizimi ekonomik i nënave të komunitetit Fuqizimi ekonomik i grave R/E dhe e drejta e tyre për	Shoqata Qendistaret	2006

			punesimi e tyre		
14	Kryqi i Kuq Shqiptar, dega Korçw		<p>- Gjetja e individëve të humbur si rezultat i ngjarjeve të tilla, si konflikt i armatosur ndërkombëtar ose jo ndërkombëtar, dizastra natyrore ose zhvendosje masive të refugjatëve.</p> <p>- Sigurimi i shërbimit të komunikimit për individë kur rrugët normale të komunikimit janë ndërprerë.</p> <p>- Dërgimi i Mesazheve në KK në situata të tilla si: konflikt i armatosur ndërkombëtar ose jondërkombëtar, fatkeqësi natyrore ose zhvendosje masive të refugjatëve.</p> <p>Trajnim vullnetarësh për Ndhmën e Parë</p> <p>Ngrita e një sistemi trajnime dhe sigurimi i bazës materiale dhe didaktike për organizimin e kurseve për përgatitje instruktorësh dhe vullnetarësh të Ndhmës së Parë dhe kurseve për rifreskim.</p> <p>Ndërgjegjësimi i publikut dhe grupeve të tjera të interesuara për nevojën e dhënies së kësaj ndihme</p> <p>Veprimtari në interes të drejtpërdrejtë të shtresave dhe grupeve në nevojë</p> <p>Nihma ushqimore për familjet dhe personat në nevojë dhe emergjencë</p>		1991
15	ShVSh Korçë	Të verbrit	<p>Përfaqësimi i të verbërve të rajonit të Korçws dhe nevojave të tyre.</p> <p>Aktivitet advokuese për mbrojtjen e të drejtave dhe mbështetjen sociale të të verbërve</p>		1991
16	Shoqata e para/tetraplegjikëve Korçë	Personat me aftësi të kufizuar para/tetraplegjikë	<p>Aktivitet advokuese për mbrojtjen e të drejtave dhe mbështetjen sociale të personave me AK para/tetraplegjikë.</p>		2006

17	Katër Qendrat ditore të moshës së tretë	Mosha e tretë	<p>Krijimi i kushteve të pershtatshme dhe ofrimi i shërbimeve psiko-sociale, mjekesore, kulturore e argetuese për të moshuarit me qëllim zbutjen e problemeve të moshës së tretë dhe shmangies e izolimit social të tyre.</p> <p>Ofrimi i një mjedisi çlodhës dhe mikëpritës për të moshuarit.</p> <p>Ofrimi i shërbimeve të specializuara sociale nëpërmjet 3 kujdestarëve të qendrave, punonjësit sociale dhe atij animator.</p> <p>Organizimi i aktiviteteve social-kulturore, argëtuese</p> <p>Përmirësimi i kushteve shëndetsore të frekuentuesve të Qendrave</p> <p>Ofrimi i shërbimeve të tjera të nevojshme për të moshuarit.</p>	Bashkia Korçë Misioni Emanuel dhe Dorcas Aid International	2007
18	Tre Qendrat ditore të fëmijëve	Fëmijët e komuniteteve në nevojë të sistemit 9 vjeçar	<p>Fëmijët Romë / Egjiptiane regjistrohen në shkollën fillore dhe janë të monitoruar pas shkollës në tre qendrat ditore të fëmijëve.</p> <p>Dhënia e një vakti të shëndetshëm ushqimor.</p> <p>Asistencë psikologjike, aktivitete sociale dhe iniciativa të tjera mbi barazine gjinore.</p> <p>Qasje në kujdesin shëndetësor dhe çështjet që lidhen me shëndetin.</p> <p>Themelimi i Komitetit të Prindërve; marrja pjesë e prindërve në vendimmarrje.</p> <p>– Rritja e Kapaciteteve arsimore të fëmijëve nëpërmjet kurseve të anglishtes, kompjuterit dhe kurseve të qepjes si dhe kurseve të gjuhës shqipe dhënë nënave të tyre.</p> <p>Trajnime mujore për prindërit për mirëushqyerjen dhe shëndetin e fëmijës nga pediatri.</p>	Bashkia Korçë Misioni Emanuel dhe Dorcas Aid International	2007
19	Qendra Multifunkionale e fëmijëve nga familjet e rikthyera nga emigracioni. Në fakt ofrohet shërbim edhe për familje të tjera në	Fëmijët e familjeve të kthyera nga emigracioni (grup mosha e sistemit 9-vjeçar shkollor)	<p>Ngritja e shërbimeve komunitare me fokus fëmijët dhe familjet vulnerabël me elementë kryesorë shërbimet e mbrojtjes, mobilizimin komunitar, mbështetjen educative dhe zhvillimire të fëmijëve</p> <p>Kurse gjuhe</p> <p>Vakt ushqimor.</p> <p>Mbështetje pas shkolle për rritjen e cilësisë së mësim nxënies</p> <p>Menaxhim rasti për shkeljen e të drejtave të fëmijëve nga</p>	Bashkia Korce, Terre des Hommes dhe Misioni Emanuel	2016

	nevojë		ana e PMF-së për nivelet e riskut të mesëm e të lartë Programe prindërimi mbi prindërimin pozitiv dhe ngritjen e grupeve të mbështetjes së njëri-tjetrit. Aktivitetë të rregullta psiko-sociale me qëllim lehtësimin e integritit të fëmijëve vulnerabël në shkollë dhe komunitet duke rritur aftësitë për rezilencën dhe aftësitë për jetën. Mbeshtetje e aktiviteteve për gjenerimin e të ardhurave të familjeve të fëmijëve vulnerabël për të siguruar mirëqënien e fëmijëve apo mbrojtjen nga shfrytëzimi për punë, migracioni i pasigurt. Edukim profesional për prindërit		
20	Formacione muzikore	Fëmijët e Qendrave ditore dhe të tjerë, kryesisht nga komuniteti R/E.	Sjellja e një numuri instrumenta muzikore nga Zvicra dhe séance mesimore me qëllim krijimin e grupeve të vogla muzikore me qëllim largimin nga rruga të fëmijëve dhe angazhimin me aktivitete të dobishme.	Bashkia Korçë, Fondacioni "Music uber Meer" Zvicer dhe "Misioni Emanuel"	2018
21	Mence Sociale	Individë në nevojë, të moshuar të braktisur.	Ofrohet dreka nga guzhina, katër here në javë	Kisha Ortodokse, Mitropolia	1998
22	Mence Sociale	Individë në nevojë, të moshuar të braktisur.	Ofrohet dreka nga guzhina, katër here në javë	Kisha "Jezu Krishti për Ballkanin"	2012
23	Qendër Sociale	Individë në nevojë, persona të braktisur.	Ofrohet dreka nga guzhina, çdo ditë për 200 persona, lavanderi, strehim emergjence, veshje	Bashkia Korçë dhe Fondacioni "Mëshirë pa kufi për Shqipërinë"	2018
24	Kampi Veror "MIQËSIA"	Fëmijë nga 6-12 vjet.	Objektivi i Kampit: 1. Integrimi i fëmijëve nga të gjitha komunitetet. 2. Edukim nëpërmjet argëtimit Ofrohet për dy turne dy-javore, nga 100 fëmijë, të ndarë në 10 grupe me nga një mësues. Programi përfshin Programe të thjeshta mësimore-edukative- tematike Lojra të ndryshme argëtuese Programet të ndërtuara në formatin e shkollës verore Një vakt ushqimor: ushqim, çdo ditë i ndryshëm fruta, pije freskuese, ujë. Në çdo turn, 40-50 fëmijë përzgjidhen nga komunitetet Rom/Egjiptian. Çdo vit, përfshihen edhe 10 fëmijë A.K. të cilët kanë në dispozicion dy mësues të specializuar.	Bashkia Korçë, "Word Vision", "Terres des Homes"	2007

Aneks 3. Legjislacioni



LIGJ Nr. 121/2016

PËR SHËRBIMET E KUJDESIT SHOQËROR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU I
FUSHA E ZBATIMIT

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Ky ligj përcakton:

- a) llojet e përfitimeve dhe lehtësive, individët dhe grupet e individëve që përmbushin kushtet për të përfituar, si dhe procedurat e kërimit e të përfitimit të të drejtave të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- b) rolin dhe përgjegjësitë e organeve publike dhe jopublike të ngarkuara me zbatimin e tij.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Shërbime të kujdesit shoqëror” është një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.
2. “Shërbime rezidenciale” janë shërbime të kujdesit njëzetekatërorësh dhe afatgjatë për individë në nevojë (fëmijë ose të rritur), të ofruara në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike.

3. "Shërbime komunitare" janë shërbime që ofrohen në qendra komunitare lokale ose në mjedise të tjera, si shërbimet e kujdesit ditor apo të zëvendësimit të përkohshëm të kujdestarit për të gjitha kategoritë e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.
4. "Shërbime parashoqërore" janë shërbime që përfshijnë informimin e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror nga ofruesit e shërbimeve, ndihmën për përfituesit në përcaktimin e nevojave të tyre, vlerësimin fillestar, mbështetjen dhe ndihmën për zgjedhjen që u përshtatet nevojave të përfituesit në sistemin e shërbimeve shoqërore.
5. "Shërbime në familje" janë shërbime të kujdesit shoqëror që ofrohen në familje për kategoritë në nevojë, që e kanë të pamundur të marrin shërbime komunitare, ditore dhe rezidenciale.
6. "Shërbime të specializuara" janë shërbimet e ofruara nga profesionistë të profilizuar në specialitetet të ndryshme. Këto shërbime ofrohen në nivel qarku/rajonat dhe bashkie për fëmijët me çrregulime pervazive të zhvillimit, prapambetje mendore, çrregullime në komunikim, në nevojë për aftësim fizik, fëmijët e abuzuar seksualisht, fëmijët në konflikt me ligjin, si dhe gratë e vajzat e abuzuara, të dhunuara apo të trafikuar, si dhe të gjitha kategoritë që kanë nevojë për shërbime të tilla.
7. "Shërbimi i këshillimit me telefon ose *on-line*" është shërbimi i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje dhe mbrojtjes së fëmijëve, sipas protokollove të hartuara dhe të miratuara.
8. "Përfitues i shërbimeve të kujdesit shoqëror" është subjekti, individi ose familja që përmbush kushtet për të përfituar të drejtat nga shërbimi shoqëror.
9. "Fëmijë" është çdo individ deri në moshën 18 vjeç.
10. "Fëmijë në nevojë për mbrojtje të veçantë" është individ deri në moshën 18 vjeç, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhencës, shfrytëzimit, trafikimit, diskriminimit, dhunës, braktisjes apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individi nën 18 vjeç, i cili ka kryer ose akuzohet se ka kryer një vepër penale.
11. "Person me aftësi të kufizuara" është individ, fëmijë ose i rritur, me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tij të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.
12. "Viktima të dhunës" janë të gjithë individët, grupet e individëve apo familjet, të cilat janë viktima dhe/ose viktima të mundshme të dhunës, përfshirë dhunën në familje ose abuzimet, sipas legjislativës në fuqi.
13. "Viktimë e trafikimit" është personi fizik që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, sipas përkufizimit të shkronjës "e", të nenit 4, të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore".
14. "Situatë emergjence" është një situatë kritike, e përkohshme ose jo, e shkaktuar nga faktorë shoqërorë, që sjellin apo mund të sjellin dëme të menjëhershme, të rënda ose që dëmtojnë seriozisht jetën, shëndetin apo mirëqenien e individit në rast se nuk merren masa urgjente dhe ndaluese.
15. "Procedurë administrative", "Akt administrativ", "Kompetenca administrative", "Organ publik", "Palë" kanë kuptimin e dhënë në Kodin e Procedurave Administrative.
16. "Kujdestar" është individ që ofron shërbime kujdestarie për të miturit sipas përcaktimeve në Kodin e Familjes.
17. "Familje kujdestare" është një familje alternative, e vendosur nga gjykata për t'i ofruar fëmijës një mjedis familjar, kushte për mirëritje, përkujdesje fizike dhe mbështetje emocionale sipas përcaktimeve të Kodit të Familjes.
18. "Ndihmës personal" është individ i zgjedhur dhe i udhëzuar nga një person me aftësi të kufizuara për ta ndihmuar këtë të fundit të kapërcejë pengesat në jetën e përditshme, sipas përcaktimeve në legjislativën në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.
19. "Diskriminimi" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predis-pozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim apo pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.
20. "Person i vetëm" është individ i cili nuk ka një familje ose që jeton i vetëm.
21. "Prind i vetëm" është prindi i/e cili/a nuk është martuar ose që kujdeset i/e vetëm/me për

fëmijën/ët e tij/saj.

22. "Person mbi moshë pune" është individi që, në çastin e vlerësimit të kriterëve për përfitimin e shërbimit shoqëror, është mbi moshën e përcaktuar të punës për atë vit, sipas legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqërore.

23. "Njësi të qeverisjes vendore" janë bashkitë dhe qarqet, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore.

24. "Punonjës social i njësive të qeverisjes vendore" është profesionisti, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, në njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve, që do të jetë përgjegjës për identifikimin e nevojave, referimin, menaxhimin dhe ndjekjen në vazhdim të rasteve.

25. "Menaxhim i rastit" është sigurimi dhe bashkërendimi i referimit të individëve në nevojë për kujdes shoqëror në të gjithë procesin e ofrimit të shërbimit, sa herë që të jetë e nevojshme, deri në integrimin e plotë të tyre.

26. "Subjekt jopublik, ofruer i shërbimeve shoqërore" është çdo ofruer jopublik i licencuar për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, nga autoriteti përgjegjës, sipas legjislacionit në fuqi për licencimin.

27. "Regjistri Elektronik Kombëtar" është baza elektronike e të dhënave të përfituesve, subjekteve ofruese, institucioneve përgjegjëse, llojit dhe kohëzgjatjes së shërbimeve të kujdesit shoqëror.

28. "Punonjës i shërbimeve sociale" është i punësuar në shërbim të kategorive përfituese të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si pjesë e sistemit publik dhe jopublik të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

29. "Tarifat e shërbimeve të kujdesit shoqëror" janë tarifat që vendosen me vendim të këshillit bashkiak në përputhje me kriteret e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas llojit të shërbimit dhe mënyrës së përcaktimit të tyre.

KREU II PARIME TË VEÇANTA

Neni 4

Parimet

Shërbimet shoqërore administrohen në bazë të parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë në bazë të këtyre parimeve themelore:

a) Parimi i universalitetit. Shërbimet e kujdesit shoqëror janë krijuar, funksionojnë dhe mbikëqyren bazuar në një sistem rregullash ligjore që ofrojnë garanci të mjaftueshme për t'u zbatuar në mënyrë të njëjtë për përfituesit që ndodhen në të njëjtat kushte.

b) Parimi i drejtësisë sociale. Çdokush ka detyrim të sigurojë kushtet bazë të jetesës për veten dhe personat, për të cilët ka detyrim ligjor t'i mbështesë dhe çdokush ka detyrim të kontribuojë me punën, të ardhurat dhe pasuritë e tij/saj për reduktimin e gjendjes së varfërisë së tij/saj apo të anëtarëve të familjes, veçanërisht fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë që nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre.

c) Parimi i subsidiaritetit. Shërbimet e kujdesit shoqëror ofrohen sa më pranë qytetarëve dhe për sa është e mundur nga strukturat vendore.

ç) Parimi i mbështetjes shoqërore. Subjektet, të cilat përmbushin kushtet për të përfituar nga shërbimet e kujdesit shoqëror, kanë të drejtën e përdorimit të tyre në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe për aq kohë sa janë në kushtet e vështirësisë e të pamundësisë.

d) Parimi i deinstitutionalizimit. Shërbimet e kujdesit shoqëror sigurohen dhe ofrohen, për aq sa është e mundur, pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit, me qëllim sigurimin e mirëqenies shoqërore dhe përdorimin me efikasitet të fondeve.

dh) Parimi i partneritetit. Funksionimi i sistemit të shërbimeve shoqërore bazohet në një bashkëpunim të ngushtë midis qeverisjes qendrore dhe vendore, si financues kryesorë të shërbimeve shoqërore me organizatat jofitimprurëse dhe subjektet e tjera jopublike, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët dhe familjet që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

e) Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, integritetit të individit, besimit fetar dhe formimin e gjithanshëm të tij.

ë) Parimi i mosdiskriminimit. Ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të

kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

f) Parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Të dhënat personale të individit, që trajtohet me shërbime të kujdesit shoqëror, janë konfidenciale dhe mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Punonjësi social, si dhe çdo person tjetër i angazhuar në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror ruan konfidencialitetin e të dhënave personale të individit, subjekt të këtij ligji, për të cilat ka marrë dijeni si pasojë e funksionit apo detyrës që kryen. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit shtrihet edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, funksionit apo detyrës.

PJESA E DYTË

KATEGORITË E SUBJEKTEVE PËRFITUESE DHE LLOJET E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

KREU I

SUBJEKTET QË GËZOJNË TË DREJTËN E PËRDORIMIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Neni 5

Kategoritë e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Të drejtën për të përdorur shërbimet e kujdesit shoqëror e kanë individë ose familje që nuk kanë mjetet minimale të jetesës dhe nuk janë në gjendje që t'i sigurojnë ato me punë apo të ardhura nga pronat ose burime të tjera, si dhe të gjithë individët që janë në pamundësi për të plotësuar nevojat e tyre të jetesës, vetë ose me ndihmën e anëtarëve të familjes, për shkak të kushteve personale dhe sociale.
2. Shërbimet e kujdesit shoqëror përdoren nga shtetasit shqiptarë me banim në Republikën e Shqipërisë.
3. Shërbimet e kujdesit shoqëror përdoren edhe nga shtetasit e huaj, personat pa shtetësi dhe refugjatët, por me banim në Republikën e Shqipërisë.
4. Personat, të cilët kanë fituar statusin e refugjatit dhe të mbrojtjes plotësuese në Republikën e Shqipërisë, gëzojnë të drejtën e kujdesit shoqëror njësoj si shtetasit shqiptarë, bazuar në dokumentacionin përkatës, të përgatitur për këtë qëllim nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, sipas legjislacionit në fuqi për azilin.

Neni 6

Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror përfshijnë këto grupe shoqërore:
 - a) familjet dhe çdo fëmijë, si dhe fëmijën që gëzon mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për azilin;
 - b) personat me aftësi të kufizuara;
 - c) të rriturit, me probleme sociale, viktimat e dhunës, trafikimit, varësisë së provuar ndaj drogës e alkoolit;
 - ç) vajzat shtatzëna apo prindi i vetëm i një fëmije deri në moshën njëvjeçare;
 - d) të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, që kanë përfunduar periudhën e dënimit dhe kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, me qëllim riintegrimin në shoqëri, si dhe ata që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare me vendim të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë;
 - dh) të moshuarit në nevojë.
2. Individit, i cili nuk përfshihet te përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas pikës 1, të këtij neni, ka të drejtë, kundrejt tarifave përkatëse, të kërkojë sistemim të përkohshëm në institucionet e ofrimit të shërbimit, qofshin këto rezidenciale apo komunitare, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj, deri në mbarimin e rrethanave të veçanta për të cilat ka kërkuar shërbimin.

Neni 7

Kategoritë që nuk përfitojnë shërbime të kujdesit shoqëror

Nuk përfitojnë shërbime të kujdesit shoqëror kategoritë e mëposhtme:

- a) shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit;
- b) azilkërkuesit, të cilët nuk kanë marrë statusin e azilit;
- c) shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët kanë nevojë për ndihmë emergjente, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe luftërave;
- ç) personat që vuajnë dënim me heqje lirie, me vendim të formës së prerë të gjykatës.

KREU II

SHËRBIMET E KUJDESIT SHOQËROR DHE MËNYRAT E OFRIMIT TË TYRE

Neni 8

Llojet e shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Shërbimet e kujdesit shoqëror janë të organizuara si shërbime në komunitet, institucione të kujdesit dhe familje për të gjitha kategoritë e identifikuar të përfituesve.
2. Llojet e shërbimeve shoqërore janë si më poshtë: a) shërbimet parashoqërore; b) shërbimet në qendrat komunitare, përfshirë qendrat e zhvillimit; c) shërbimet në qendrat rezidenciale, përfshirë strehëzat; ç) shërbimet shoqërore në situatë emergjente; d) shërbimet e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror; dh) shërbimet e specializuara; e) shërbimi i këshillimit me telefon ose *on-line*.
3. Shërbimet e kujdesit shoqëror janë shërbime rezidenciale kur është i pashmangshëm dhe i papërshtatshëm ofrimi i tyre në familje apo komunitet.
4. Kërkesa dhe dokumentacioni për të përdorur shërbime të kujdesit shoqëror paraqiten te punonjësi social i njësisë së qeverisjes vendore, pjesë e strukturave të vlerësimit të nevojave dhe referimit në njësitë e qeverisjes vendore.
5. Kriteret dhe procedurat e pranimit në qendrat rezidenciale dhe për përdorimin e shërbimeve në komunitet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Klasifikimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Shërbimet e kujdesit shoqëror, sipas mënyrës së financimit, klasifikohen në shërbime publike dhe jopublike.
2. Në shërbimet shoqërore publike përfshihen shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat komunitare, qendrat rezidenciale, qendrat ditore ose në shtëpi. Këto shërbime financohen nga Buxheti i Shtetit dhe nga buxhetet vendore të organeve të qeverisjes vendore.
3. Shërbimet jopublike klasifikohen në shërbime fitimprurëse dhe jofitimprurëse. Shërbimet shoqërore fitimprurëse nuk mund të kërkojnë apo përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit dhe ai i bashkive. Shërbimet shoqërore jofitimprurëse gëzojnë të drejtën të kërkojnë apo përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit apo ai i bashkive, vetëm nëse kanë lidhur kontratë me subjektin që ka përgjegjësi për të ofruar shërbimin e kujdesit shoqëror.
4. Shërbimet shoqërore të specializuara janë pjesë e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ofrohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe nga njësitë e qeverisjes vendore në nivel qarku.
5. Në shërbimet shoqërore jopublike përfshihen shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat rezidenciale, në qendrat ditore ose në shtëpi nga subjekte jopublike.

Neni 10

Shërbimet parashoqërore

1. Shërbimet parashoqërore konsiderohen si shërbime komunitare dhe përbëhen nga: a) informimi dhe këshillimi;
b) shërbimi në familje;
c) mbështetja psiko-sociale;
ç) ndërhyrja e hershme.
2. Shërbimet parashoqërore sigurohen nga profesionistë të caktuar nga struktura të vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë njësive të qeverisjes vendore.

Neni 11

Informimi dhe këshillimi

Informimi dhe këshillimi janë shërbime që synojnë përmirësimin e situatës së individit, duke e orientuar rreth mundësive më të përshtatshme për nevojat e tij, në sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Neni 12

Shërbimi në familje

1. Shërbimi në familje është shërbim ndaj individit, person i vetëm, që jepet në shtëpi ose në familjen kujdestare.
2. Shërbimi në familje u njihet fëmijëve, të moshuarve, personave me aftësi të kufizuara, të cilët janë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari.
3. Shërbimi në familje është një kombinim shërbimesh të kujdesit ditor që përfshin: a) furnizimin dhe shpërndarjen e ushqimeve të gatshme në shtëpi;
b) furnizim të barnave apo furnizime të tjera;
c) mbajtjen e higjienës personale;
ç) përmbushjen e nevojave të tjera të përditshme, sipas vlerësimit, rast pas rasti; d) mbështetjen psiko-sociale.

Neni 13

Mbështetja psiko-sociale

1. Mbështetja psiko-sociale ofrohet individualisht ose në grup dhe synon inkurajimin, rehabilitimin, zhvillimin e aftësive njohëse, funksionale, komunikuese apo shoqërore të përfituesve.
2. Kur vlerësohet e nevojshme nga strukturat e vlerësimit të nevojave dhe referimit, mbështetja psiko-sociale mund të jepet edhe si pjesë e shërbimeve të specializuara.

Neni 14

Ndërhyrja e hershme

1. Ndërhyrja e hershme është një shërbim shoqëror individual që ofrohet në familje, në qendra sociale për ofrimin e shërbimeve në komunitet ose institucionet e arsimit të detyrueshëm dhe konsiston në ndihmë profesionale dhe stimuluese për fëmijët deri në 8 vjeç, asistencë këshilluese për prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes me lidhje gjaku ose për familjen kujdestare, me qëllim riintegrimin në shoqëri të fëmijës.
2. Ndërhyrja e hershme përfshin referimin e rastit të fëmijës te një qendër e shërbimeve shoqërore e specializuar, institucion i arsimit të detyrueshëm apo institucion mjekësor, sipas karakteristikave të

veçanta të fëmijës.

Neni 15

Shërbimet komunitare

1. Shërbimet e kujdesit shoqëror, të ofruara kryesisht në qendra komunitare, ofrohen si shërbime të plota ditore ose gjysmëditore.
2. Qëndrimi i plotë ditor zgjat nga gjashtë deri në tetë orë në ditë, ndërsa qëndrimi gjysmëditor nuk mund të jetë më shumë se gjashtë orë në ditë.
3. Gjatë kohës së qëndrimit në qendrën komunitare garantohet siguria fizike, jepen shërbime për higjienën personale, kujdesin shëndetësor, edukimin, rehabilitimin psiko-social, kalimin e kohës së lirë në komunitet, fuqizimin e individit/familjes, si dhe çdo shërbim tjetër i nevojshëm, sipas nevojave të identifikuar të përfituesit.
4. Shërbimet e plota ditore mund të përdoren një ose disa ditë në javë ose gjatë të gjitha ditëve të punës.
5. Kushtet dhe mënyra e ofrimit të shërbimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16

Shërbimet në qendrat e zhvillimit

1. Shërbimet në qendrat e zhvillimit janë shërbime komunitare që synojnë sigurimin dhe përmirësimin e statusit dhe cilësisë së jetës së individëve me aftësi të kufizuara, deri në 21 vjeç.
2. Llojet e shërbimeve, që ofrohen në qendrat e zhvillimit janë si më poshtë:
 - a) terapi intensive psiko-sociale për aftësimin mendor dhe rehabilitimin social me qëllim integrimin në komunitet;
 - b) shërbim psikomotor për aftësimin dhe përmirësimin e parametrave psikologjikë dhe të motorikës fine e globale;
 - c) aftësim i parametrave fizikë;
 - ç) shërbime të specializuara ortofonie për aftësimin e individëve me çrregullime të spektrit autik apo aftësisë për të komunikuar;
 - d) terapi riaftësimi për punë; dh) terapi zhvillimi.

Neni 17

Strehëzat

1. Shërbimi në strehëza është shërbim i kujdesit shoqëror rezidencial i ofruar në mënyrë të përkohshme, që përfshin shërbimin e specializuar, strehimin, sigurinë fizike, ushqimin, kujdesin shëndetësor, rehabilitimin psiko-social, terapinë fizike, aktivitete profesionale, kalimin e kohës në komunitet, edukimin, në varësi të nevojave të identifikuar dhe të zgjedhura nga përfituesit.
2. Përfituesit e shërbimit në streha janë:
 - a) fëmija, i cili gjendet i pambikëqyrrur nga prindërit, në rrezik, apo në situatë rruge;
 - b) fëmija në nevojë të mbrojtjes së veçantë;
 - c) i rrituri, ose i moshuari, i cili nuk ka vendbanim të përhershëm apo të përkohshëm dhe nuk është në gjendje të kujdeset për veten;
 - ç) gratë dhe vajzat shtatzëna ose prindi i vetëm me fëmijë deri në 1 vjeç;
 - d) fëmijët dhe të rriturit, viktimat të dhunës në familje, abuzimit, viktimat të trafikimit apo viktimat mundshme të trafikimit ose në rrezik potencial për jetën;
 - dh) fëmijët dhe të rriturit në rrezik për shkak të situatës shëndetësore, aftësisë së kufizuar, varësive nga droga ose alkooli apo përjashtimi social.
3. Ky shërbim mund të ofrohet gjatë të gjitha ditëve të javës dhe përfshin edhe referimin në një shërbim tjetër shoqëror.

Neni 18

Strehimi i përkohshëm

1. Strehimi i përkohshëm është një shërbim i ofruar ndaj individëve që ndodhen në rrethana të vështira dhe emergjente, deri në referimin e tyre të një shërbimi tjetër shoqëror.
2. Përfituesit e këtij shërbimi nuk kalojnë në procesin e zakonshëm të vlerësimit të rastit, por vetëm referohen nëpërmjet punonjësit social.
3. Pas kalimit të situatës së emergjencës, struktura përgjegjëse për vlerësimin dhe referimin bën vlerësimin e mëtejshëm të rastit për personin në nevojë.
4. Ky shërbim strehimi mund të jepet edhe në familjen me lidhje gjaku ose familjen kujdestare.
5. Strehimi i përkohshëm zgjat deri në gjashtë muaj, por mund të zgjatë deri në një vit, rast pas rasti.

Neni 19

Trajtimi i fëmijës në situatat e emergjencës

1. Në rast se një punonjës social i njësishëm së qeverisjes vendore informohet ose beson në mënyrë të arsyeshme se fëmija ndodhet në situatë emergjente, ndërmerret veprimet e mëposhtme:
 - a) largon fëmijën nga vendndodhja aktuale dhe e strehon atë në strehën e përkohshme më të afërt;
 - b) ndihmon fëmijën duke e dërguar në spital ose informon menjëherë policinë në rast se situata e kërkon;
 - c) komunikon me fëmijën për të kuptuar situatën e tij;
 - ç) informon fëmijën mbi hapat që duhen ndjekur sipas këtij neni. d) referon fëmijën në njësinë e mbrojtjes së fëmijës.
2. Menjëherë pas dërgimit të fëmijës në strehën e përkohshme, punonjësi social informon prindërit ose përfaqësuesin ligjor të fëmijës.
3. Strehja e përkohshme ku është strehuar fëmija bën kërkesë për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje në gjykatën kompetente, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e fëmijës, duke legjitimuar qëndrimin e tij në qendrat e kujdesit shoqëror.
4. Në rast se gjykata lëshon urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, fëmija qëndron në qendrat e kujdesit shoqëror, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë ligj.
5. Pas lëshimit të urdhrin të mbrojtjes, institucioni i kujdesit shoqëror, në rast se e diktojnë rrethanat, paraqet përpara gjykatës një kërkesë për vendosjen ose zëvendësimin e kujdestarisë.
6. Në rast se gjykata nuk e gjykon të arsyeshëm lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, punonjësi social i njësishëm së qeverisjes vendore monitoron mirëqenien e fëmijës pranë familjes.

Neni 20

Trajtimi i fëmijëve të shfrytëzuar ose të trafikuar

Institucionet, të cilat me ligj janë përgjegjëse për trajtimin e fëmijëve të shfrytëzuar ose të trafikuar, janë të detyruara të ndërmarrin të gjitha masat dhe veprimet specifike për të ndihmuar dhe mbështetur fëmijët, viktimat të shfrytëzimit ose trafikimit, deri në shërimin e tyre fizik dhe psiko-social, pas një vlerësimi të veçantë të rrethanave të secilit fëmijë, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme, sipas ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore".

Neni 21

Shërbimet në qendrat rezidenciale

1. Shërbime në qendrat rezidenciale konsiderohen shërbimet e strehimit afatgjatë dhe të organizuar që u ofrohet kategorive në nevojë, për të cilat kujdesi në shtëpi nuk është i mundur.
2. Vendosja e kategorive në nevojë në qendrat e kujdesit shoqëror bëhet me pëlqimin e individit ose përfaqësuesit të tij ligjor pas vlerësimit të gjendjes shoqërore, ekonomike dhe mjekësore të individit.

Neni 22

Strehimi afatgjatë

1. Strehimi afatgjatë u sigurohet individëve që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm, me qëllim përmbushjen e nevojave themelore, kur ky kujdes nuk u sigurohet dot në familje apo familje kujdestare.
2. Personat që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm janë:
 - a) personat me aftësi të kufizuara, sipas moshës, llojit dhe shkallës së dëmtimit, kur nuk është e mundur të sigurohet kujdesi në familje, duke i dhënë format e duhura institucionale të kujdesit;
 - b) të moshuarit dhe të sëmurët rëndë, të cilët vuajnë nga ndryshime të përhershme të gjendjes shëndetësore.

Neni 23

Strehimi i organizuar

1. Strehimi i organizuar është një shërbim i kujdesit shoqëror në nivel vendor, i cili ofrohet për 24 orë në ditë në qendrat rezidenciale për të përmbushur nevojat themelore sociale, kulturore, arsimore, rekreative dhe përfituesve nga subjekte publike ose jopublike.
2. Strehimi i organizuar u ofrohet të moshuarve, jetimëve, fëmijëve pa kujdes prindëror ose pa kujdestari, personave me aftësi të kufizuara, duke u dhënë format e duhura rezidenciale të kujdesit, kur janë shteruar të gjitha mundësitë për të siguruar kujdesin në familje, familje kujdestare apo qendra komunitare.
3. Përfituesve të shërbimeve të strehimit të organizuar u jepet një shumë në lekë për shpenzime personale. Kjo shumë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Personat, që kanë dëshirë të përdorin shërbimin e strehimit të organizuar dhe kanë të ardhura personale, mund të pranohen në institucionet publike të strehimit të organizuar, kundrejt një tarife.
5. Në çdo rast, përparësi për t'u pranuar në shërbimin e strehimit të organizuar do të kenë kategoritë e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

Neni 24

Shërbimet e përkujdesjes alternative për fëmijët pa kujdes prindëror

1. Fëmijës së privuar në mënyrë të përkohshme/të përhershme nga mjedisi familjar ose kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në këtë mjedis i sigurohet një përkujdesje alternative.
2. Përkujdesja alternative mund të jetë:
 - a) vendosja në një familje alternative ose në një institucion të përkujdesjes për fëmijë;
 - b) vendosja në një familje birësuese.
3. Shërbimet e përkujdesjes alternative për fëmijët pa kujdes prindëror ofrohen në familjen kujdestare, sipas nevojave specifike të fëmijës, të parashikuara në legjislacionin në fuqi.
4. Procedura e evidentimit të familjes kujdestare organizohet dhe mbikëqyret nga strukturat e shërbimeve shoqërore të organeve të njëjësive të qeverisjes vendore, të cilat ngrënë pranë tyre komisionet multidisiplinare për vlerësimin e rasteve. Organizimi dhe funksionimi i komisioneve multidisiplinare përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.
5. Kriteret, dokumentacioni dhe procedura që do të ndiqet nga strukturat e shërbimeve shoqërore të organeve të njëjësive të qeverisjes vendore, për evidentimin e familjeve kujdestare, si dhe masa e financimit për shpenzimet e fëmijës të vendosur në familje kujdestare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Ministri përgjegjës për çështjet sociale nxjerr udhëzim për procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimeve.

Neni 25

Shërbimet publike

1. Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror përfitojnë shërbimet publike, si arsimimi dhe shëndetësia. Shpenzimet e tyre mbulohen nga Buxheti i Shtetit.
2. Përfituesit e shërbimeve shoqërore, të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor. Kontributi në fondin e sigurimeve të detyrueshme shëndetësore për këto kategori paguhet nga Buxheti i Shtetit.

PJESA E TRETË

ADMINISTRIMI DHE FUNKSIONIMI I SISTEMIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

KREU I

Neni 26

Kriteret e përgjithshme të funksionimit dhe bashkërendimit

1. Sistemi i shërbimeve të kujdesit shoqëror ofron shërbime, falas ose kundrejt tarifave, sipas rasteve të përcaktuara në këtë ligj.
2. Në çdo rast, metodologjia e përcaktimit të tarifave dhe nivelit të tyre do të bëhet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe të Ministrit të Financave.
3. Koordinimi dhe mbështetja e përgjithshme e shërbimeve të kujdesit shoqëror bëhet nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.

Neni 27

Subjektet e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Shërbimet e kujdesit shoqëror ofrohen nga personat juridikë publikë apo jopublikë, të licencuar për këtë qëllim. Licencimi i veprimtarive të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe subjekteve të ofrimit të tyre, të përcaktuara në këtë ligj, bëhet nga autoriteti përgjegjës, sipas legjislacionit në fuqi për licencat.
2. Shërbimet e kujdesit shoqëror të financuara privatisht ofrohen nga subjekte jopublike, por sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.
3. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, në çdo rast, bëhet në përputhje me standardet e hartuara nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.

Neni 28

Pranimi në sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Pranimi në sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror fillon me kërkesë të individit në nevojë, përfaqësuesit të tij, psikologut, por mund të fillojë edhe kryesisht nga punonjësi social i njësisë së qeverisjes vendore kur konstatohet situata e nevojës për shërbime.
2. Kërkesa për të përfituar shërbime të kujdesit shoqëror paraqitet te punonjësi social i njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit në strukturën e posaçme për shërbimet shoqërore të njësisë së qeverisjes vendore.
3. Këshilli bashkiak vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës për pranimin në sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Vendimet e këshillit bashkiak mund të ankimohen në rrugë gjyqësore.
4. Në rast se shërbimi i kujdesit shoqëror për individin nuk ofrohet nga ajo njësi e qeverisjes vendore, kryetari i bashkisë referon rastin te një njësi tjetër e qeverisjes vendore, vetë ose nëpërmjet drejtorisë rajone të Shërbimit Social Shtetëror. Vendimet e kryetarit të bashkisë mund të ankimohen në rrugë gjyqësore.

Neni 29

Regjistri Elektronik Kombëtar

1. Regjistri Elektronik Kombëtar administrohet në nivel qendror nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe aksesohet nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore.
2. Çdo njësi e qeverisjes vendore ka detyrimin për të hedhur në regjistër të dhënat që disponon dhe për të raportuar periodikisht në Shërbimin Social Shtetëror.
3. Të dhënat e hedhura në regjistër grumbullohen nga Shërbimi Social Shtetëror dhe i raportohen në mënyrë periodike ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.
4. Regjistri Elektronik Kombëtar ngrihet dhe administrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për bazën e të dhënave shtetërore.
5. Rregullat specifike të funksionimit e të administrimit të Regjistrimit Elektronik Kombëtar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 30

Përgjegjësia për zbatimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Zbatimi i sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, që financohen nga Buxheti i Shtetit dhe nga buxhetet e njësive të qeverisjes vendore, është përgjegjësi e organeve publike të ngarkuara me këtë detyrë, në nivel qendror dhe vendor.
2. Institucionet kryesore përgjegjëse për administrimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror janë si më poshtë:
 - a) ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe institucionet e saj të varësisë; b) qarku; c) bashkia.

Neni 31

Roli i ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale

1. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale organizon dhe administron sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në përputhje me kërkesat dhe standardet e ofrimit të tyre.
2. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale ka këto role dhe funksione kryesore:
 - a) harton dokumentet e politikave të reformimit e të modernizimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, me synim rritjen e efektivitetit dhe ofrimin e tyre;
 - b) harton dhe përditëson standardet minimale të ofrimit të shërbimeve;
 - c) harton dhe/ose propozon akte ligjore e nënligjore për plotësimin e kuadrit rregullator të funksionimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
 - ç) përcakton kriteret dhe kushtet që duhet të përmbushin subjektet e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
 - d) harton dhe ndërmerr fushata ndërgjegjësimi që inkurajojnë ndihmën, punën vullnetare dhe format e tjera të mbështetjes në favor të individëve dhe familjeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror;
 - dh) harton dokumente bashkëpunimi mes aktorëve të përfshirë në zbatimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, me qëllim koordinimin e bashkëpunimit në mënyrë efektive;
 - e) programon, si zë më vete në buxhet, fondet për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, që u delegohet bashkive si transfertë në fondin social;
 - ë) harton dhe miraton manuale trajnimi e edukimi për mënyrën e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror nga ana e subjekteve ofruese, me qëllim zbatimin me uniformitet të ligjit;
 - f) këshillon dhe udhëzon njësitë e qeverisjes vendore në lidhje me strukturat që duhet të ngrihen prej tyre për zbatimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe mënyrat e planifikimit e të ofrimit të shërbimeve;
 - g) harton dhe paraqet për miratim nevojat për financim nga Buxheti i Shtetit për aktivitetet e

shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Neni 32

Shërbimi Social Shtetëror

1. Shërbimi Social Shtetëror është institucion në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.
2. Statuti i Shërbimit Social Shtetëror miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Struktura dhe organika e Shërbimit Social Shtetëror miratohet me urdhër të Kryeministrit.

Neni 33

Roli i Shërbimit Social Shtetëror

1. Shërbimi Social Shtetëror monitoron zbatimin e legjislationit të shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin, nëpërmjet strukturave të njësisë qendrore dhe drejtorive rajonale.
2. Shërbimi Social Shtetëror ka këto role dhe funksione kryesore:
 - a) harton dokumentacionin tip për përfituesit e shërbimeve shoqërore;
 - b) kryen vlerësimin e nevojave të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
 - c) mbledh, analizon dhe përpunon informacionin mbi ecurinë e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe raporton periodikisht në ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale;
 - ç) harton raportin vjetor të vlerësimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror dhe kapaciteteve të shërbimeve publike e jopublike;
 - d) trajnon personelin e njësisë të qeverisjes vendore që mbulon aspektet e shërbimeve shoqërore;
 - dh) bashkërendon procesin e hartimit të planeve sociale, duke siguruar që këto plane të përputhen me strategjitë kombëtare;
 - e) përditëson dhe mirëmban Regjistrin Elektronik Kombëtar me të dhënat për përfituesit dhe subjektet kërkuese të kujdesit shoqëror;
 - ë) i dërgon ministrisë statistikat sociale të lidhura me shërbimet e kujdesit shoqëror dhe pagesat sociale.

Neni 34

Roli i Inspektoratit të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror

1. Inspektorati, që mbulon fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në vijim Inspektorati, është personi juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.
2. Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror ka përgjegjësi të kontrollojë dhe të verifikojë respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror.
3. Inspektorati funksionon sipas këtij ligji dhe ligjit që rregullon inspektimin në Republikën e Shqipërisë.
4. Mënyra e organizimit, funksionimit dhe veprimtarisë së Inspektoratit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Struktura dhe organika e Inspektoratit miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

Neni 35

Funksionet dhe kompetencat e Inspektoratit

1. Inspektorati, në zbatim të këtij ligji, kryen këto funksione:
 - a) kontrollon zbatimin e kriterëve e të kushteve nga subjektet publike dhe jopublike që ushtrojnë veprimtari të ofrimit të shërbimeve shoqërore, sipas këtij ligji, akteve nënligjore në zbatim të tij dhe akteve të tjera ligjore në fuqi;
 - b) inspekton standardet e shërbimeve të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror;
 - c) bashkëpunon dhe u jep informacion organeve të tjera shtetërore për rastet që janë në kompetencë

- të tyre, në lidhje me veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- ç) ushtron kontroll në mjediset dhe në dokumentacionin e subjekteve që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror, të cilat kanë detyrimin të lejojnë dhe të vënë në dispozicion të Inspektoratit informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për inspektim;
- d) vendos gjoha dhe masa të tjera administrative ndaj subjekteve publike dhe jopublike, kur vëren shkelje të dispozitave të këtij ligji;
- dh) i propozon ministrit përgjegjës për çështjet sociale heqjen e licencës së ofruesit të shërbimit shoqëror, i cili, brenda dhjetë ditëve, merr vendimin përfundimtar mbi propozimin e marrë;
- e) raporton periodikisht në ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale mbi rezultatet e inspektimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.
2. Inspektorati shqyrton ankesat ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtari të ofrimit të shërbimeve shoqërore, të marra drejtpërdrejt ose të përcjella nga çdo institucion tjetër apo individ.
3. Inspektorati merr vendim, pas shqyrtimit të ankesave, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe në përputhje me kompetencat e dhëna me këtë ligj.
4. Rregullorja e shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

Neni 36

Roli i bashkisë

1. Bashkia ofron dhe administron shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj: a) duke identifikuar nevojat;
- b) duke vlerësuar nevojat në bazë të hartës së vulnerabilitetit;
- c) duke hartuar planin social vendor;
- ç) duke programuar buxhetet vendore;
- d) duke planifikuar shportën bazë të shërbimeve shoqërore;
- dh) duke kontraktuar ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik;
- e) duke bashkërenduar me Shërbimin Social Shtetëror shërbimet e nevojshme të kujdesit shoqëror.
2. Për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror pranë bashkive ngrihen struktura të posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror.
3. Pranë çdo njësie administrative, në varësi të bashkisë, ngrihet njësi e vlerësimit të nevojave dhe referimit.
4. Bashkia cakton nga një punonjës social të njësisë së qeverisjes vendore për gjashtë deri në dhjetë mijë banorë.
5. Bashkitë, me numër popullsie më pak se gjashtë mijë banorë, orientohen dhe mbështeten në funksionet e tyre nga zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

Neni 37

Roli i punonjësit social të njësisë së qeverisjes vendore

- Punonjësit socialë në njësinë e qeverisjes vendore janë pjesë e strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe/ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit dhe kanë për detyrë:
- a) të verifikojnë gjendjen shoqërore dhe ekonomike të individëve e të familjeve që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror nëpërmjet identifikimit të rasteve;
- b) të ndihmojnë në përgatitjen e dokumentacionit për personat që aplikojnë për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror nëpërmjet këshillimit, ndërmjetësimin dhe referimit në shërbimet sociale në nivel vendor, rajonal apo kombëtar;
- c) të marrin pjesë në procesin e hartimit të planeve të kujdesit për personat që do të trajtohen apo të cilëve u refuzohen shërbimet e kujdesit shoqëror nëpërmjet vlerësimit, ndjekjes, monitorimit dhe mbylljes së rastit;
- ç) të përgatitin dokumentacionin dhe propozimet për miratim nga këshilli bashkiak;
- d) të grumbullojnë dhe të hartojnë informacione, statistika dhe të mbajnë regjistrin e përfituesve, të

ndjekin shpenzimet për personat që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror;
dh) të grumbullojnë informacione për rrjetet e shërbimeve publike dhe jopublike që veprojnë në territorin e bashkisë.

Neni 38

Roli i qarkut

1. Këshilli i qarkut harton planin social rajonal të bashkërenduar me planet sociale të njësive të qeverisjes vendore dhe ia paraqet ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.
2. Kryetari i qarkut vendos ofrimin e shërbimeve të specializuara në bashkërendim rajonal të rasteve për shërbimet e kujdesit shoqëror të vendosura në nivel rajonal.
3. Kryetari i qarkut krijon komitetin e planifikimit të nevojave “*ad hoc*”, të përbërë nga përfaqësues të të gjitha strukturave vendore /rajonale dhe shoqërisë civile, me pjesëmarrje vullnetare.

KREU II

AKREDITIMI DHE EDUKIMI I VAZHUESHËM

Neni 39

Akreditimi

1. Të gjitha subjektet publike/jopublike, fitimprurëse ose jofitimprurëse, të huaja dhe vendase, që kanë ekspertizë dhe eksperiencë në organizimin e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të licencuara për ofrimin e trajnimeve e të kualifikimeve, akreditohen nga ministria përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror, në mënyrë periodike, për të vlerësuar shkallën e plotësimin nga ana e tyre të standardeve të paracaktuara për to nga Këshilli i Ministrave.
2. Rregullat dhe mënyra e realizimit të procesit të akreditimit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 40

Profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Regjistrimi i profesionistëve është një proces i detyrueshëm, i cili bëhet nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.
2. Ministri përgjegjës për çështjet sociale miraton, me urdhër, rregulloren për procedurat e regjistrimit dhe reregjistrimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Neni 41

Urdhrat e profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror regjistrohen pranë urdhrave profesionistë përkatës dhe janë subjekt i detyrave dhe përfitimeve korresponduese.
2. Funkionimi i urdhrave të profesionistëve rregullohet me ligje të veçanta.

Neni 42

Edukimi i vazhdueshëm profesional

1. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale krijon një program të detyrueshëm për edukimin e vazhdueshëm profesional, i quajtur “Programi i certifikimit për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, program i cili është sistem i bazuar në cikle periodike, brenda të cilave profesionistët duhet të mbledhin një numër të caktuar kreditesh të edukimit të vazhdueshëm profesional, bazuar në

procedurat, kriteret dhe standardet e miratuara nga Këshilli i Ministrave. Certifikimi është procesi që profesionisti i shërbimeve të kujdesit shoqëror përfundon me përbushjen e kriterëve të secilit cikël të programit të certifikimit dhe lidhet me ecjen në karrierë të profesionistit të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore.

2. Profesionistët e ndihmës e të shërbimeve shoqërore janë të detyruar që t'i nënshtrohen edukimit të vazhdueshëm profesional të përditësuar për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që të rritin cilësinë e shërbimeve.

3. Punësimi ose kontratat në institucionet e kujdesit shoqëror, publike dhe jopublike, pezullohen nëse profesionisti i shërbimeve të kujdesit shoqëror nuk merr asnjë kredit të edukimit të vazhdueshëm. Rifitimi i së drejtës për punësim ose lidhja e kontratave të punës me institucionet bëhet pasi profesionisti t'i jetë nënshtruar provimit të certifikimit. Nëse profesionisti i shërbimeve të kujdesit shoqëror mbledh kredite të edukimit të vazhdueshëm, por më pak se limiti i kërkuar, ai duhet t'i nënshtrohet provimit të certifikimit brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit. Nëse dështon në provim, punësimi ose kontratat në institucionet e tjera pezullohen. Rifitimi i së drejtës për punësim ose kontrata me institucionet e kujdesit shoqëror, publike dhe jopublike, bëhet pasi profesionisti të ketë kaluar me sukses provimin e certifikimit. Institucionet publike dhe jopublike të shërbimeve të kujdesit shoqëror janë të detyruara të hartojnë dhe të zbatojnë programe të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e tyre.

4. Institucionet, që merren me shërbimet e kujdesit shoqëror, u nënshtrohen sanksioneve, në rast se ato punësojnë specialistë të cilët nuk përbushin kërkesat e parashikuara në këtë nen.

5. Institucionet, që merren me shërbimet e kujdesit shoqëror, lehtësojnë edukimin e vazhdueshëm profesional të profesionistëve të kujdesit shoqëror.

Neni 43

Sigurimi i cilësisë së aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm, akreditimi

1. Akreditimi është procesi i miratimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm ose/dhe i ofruesit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm, bazuar në procedurat, standardet dhe kriteret e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Ofrues të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm janë të gjitha strukturat publike ose jopublike, fitimprurëse ose jofitimprurëse, të huaja dhe të vendit, që kanë ekspertizë dhe eksperiencë në organizimin e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm në fushën e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore, sipas kriterëve të miratuara.

3. Ofruesit e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm janë të detyruar të sigurojnë cilësinë e aktiviteteve që zhvillojnë, përmes respektimit të kriterëve të cilësisë e akreditimit dhe standardeve të edukimit të vazhdueshëm profesional.

4. Kriteret, standardet dhe procedurat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm, si dhe të ofruesve të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 44

Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm

1. Pranë ministrisë përgjegjëse për ndihmën dhe shërbimet shoqërore funksionon Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për ndihmën dhe shërbimet shoqërore dhe ka në përbërje një përfaqësues nga:

- a) Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim;
- b) Shërbimi Social Shtetëror;
- c) ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- ç) Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve;
- d) Urdhri i Infermierëve;
- dh) Urdhri i Punonjësit Social;
- e) Urdhri i Psikologut.

2. Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm është organi më i lartë vendimmarrës në sistemin e certifikimit dhe ricertifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe të akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm. Ky bord mbledhet jo më pak se katër herë në vit dhe, për raste të veçanta, kur është e nevojshme, kryetari mund ta mbledhë atë edhe më shpesh. Mbledhjet e bordit janë të vlefshme kur në to marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Vendimmarrja në Bordin e Edukimit të Vazhdueshëm bëhet me shumicë të thjeshtë.

3. Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm kryen këto funksione kryesore:

- a) harton kriteret, standardet e procedurat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm e të ofruesve të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm, si dhe kriteret e procedurat e procesit të certifikimit dhe/ose ricertifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- b) miraton tarifat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm;
- c) miraton listën e ekspertëve të pavarur për secilën fushë ekspertize, të cilët do të përfshihen në vlerësimin e jashtëm të aktiviteteve, si pjesë e procesit të akreditimit, dhe masën e pagesës së tyre, sipas legjislacionit në fuqi;
- ç) shqyrton ankesat e bëra nga profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror për procedurat e njohjes e të regjistrimit të krediteve përkatëse;
- d) shqyrton ankesat e bëra nga ofruesit e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm për procesin e vlerësimit të jashtëm, të cilat nuk janë zgjidhur nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim;
- dh) ndërmerri masat e nevojshme për realizimin e provimit të ricertifikimit për të gjithë profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror që nuk përmbushin kërkesat e programit të certifikimit;
- e) monitoron zbatimin e programit të certifikimit për të siguruar përmbushjen e detyrave të institucioneve përgjegjëse.

4. Anëtarët e Bordit të Edukimit të Vazhdueshëm shpërblehen sipas legjislacionit në fuqi për shpërblimin e anëtarëve të bordeve, këshillave ose komisioneve.

KREU III

FINANCIMI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Neni 45

Burimet e financimit

Burimet e financimit për shërbimet e kujdesit shoqëror, që realizohen nga institucionet publike dhe jopublike, përbëhen nga:

- a) fondet e deleguara nga Buxheti i Shtetit, përfshirë fondin social;
- b) fondet nga buxhetet e njësisve të qeverisjes vendore;
- c) të ardhurat e caktuara nga pasuritë dhe veprimtari të tjera të bashkisë; ç) tarifat e shërbimit për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Neni 46

Mekanizmat e financimit

1. Njësia e qeverisjes vendore planifikon, ndërton, administron dhe mirëmban rregullisht shërbimet e kujdesit shoqëror, të ofruara brenda territorit të saj nëpërmjet buxhetit të njësisë së qeverisjes vendore.

2. Ministri përgjegjës për çështjet sociale udhëzon njësitë e qeverisjes vendore për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen kundrejt pagesës së tarifave zbatojnë kriteret e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave dhe bëhen pjesë e paketës fiskale dhe buxhetit vjetor të bashkisë. Në parim, tarifat paguhën nga përfituesi i shërbimit të kujdesit shoqëror dhe synojnë të mbulojnë një pjesë të shpenzimeve korrente për njësitë e shërbimit në fjalë.

3. Tarifat e shërbimeve publike të financuara nga Buxheti i Shtetit caktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe të Ministrit të Financave, si më poshtë:

- a) kontributet e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji;

b) dhurimet, sponsorizimet, donacionet dhe financime të tjera nga organizata, persona fizikë ose juridikë.

Neni 47

Fondi social

1. Bashkia, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, krijon dhe administron fondin social, nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitë e qeverisjes vendore, me qëllim përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, krijimin e shërbimeve të reja, si dhe për zhvillimin e politikave sociale. Ndalohet përdorimi i fondit social për financimin e qëllimeve të tjera nga ato të përcaktuara në këtë pikë.
2. Fondi social përbëhet nga:
 - a) të ardhurat vjetore nga Buxheti i Shtetit;
 - b) financime jashtëbuxhetore nga organizata vendase apo të huaja ose persona të tjerë;
 - c) të ardhurat nga zbatimi i tarifave për shërbime të ndryshme të kujdesit shoqëror;
 - c) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
 - d) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron bashkia.
3. Mjetet financiare në fondin social, të papërdorura në vitin fiskal ushtrimor, mbarten në buxhetin e vitit pasardhës si pjesë e fondit social.
4. Procedurat e krijimit e të funksionimit të fondit social rregullohen dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 48

Fondet e financimit

1. Në lidhje me financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror nga Buxheti i Shtetit, ministria përgjegjëse për çështjet sociale parashikon në buxhetin e vet fonde për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat u transferohen njësisë të qeverisjes vendore ku funksionojnë këto shërbime të kujdesit shoqëror. Në këtë rast, ministri përgjegjës për çështjet sociale shpërndan dhe transferon në fillim të vitit, në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, fondin social dhe transfertat të tjera për çdo shërbim të kujdesit shoqëror, duke marrë parasysh kriterin e nevojës më të madhe dhe prioritetet e të çdo njësisë të qeverisjes vendore në ofrimin e këtyre shërbimeve.
2. Metodologjia e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror përcaktohet nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Fondet nga Buxheti i Shtetit për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror përcaktohen në përputhje me vlerësimin e nevojave dhe me mundësitë e Buxhetit të Shtetit.

KREU IV

Neni 49

Sanksionet

1. Shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në nenet 25, 27, pika 2, 35, 37 e 38, të këtij ligji, dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, kur nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe:
 - a) dënohen me gjobë, sipas ligjit për kundërvajtjet administrative;
 - b) ndëshkohen me masë disiplinore.
2. Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, me qëllim zbatimin e legjislacionit për shërbimet e kujdesit shoqëror, vendos këto sanksione:
 - a) kur konstaton kundërvajtje administrative për rastet e shkeljeve të detyrimeve të përcaktuara në nenin 25, të këtij ligji, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, vendos ndaj subjekteve ofruese të

shërbimeve të kujdesit shoqëror gjoba nga 50 mijë lekë deri në 100 mijë lekë dhe pezullimin e licencës së subjekteve jopublike në rast të parregullsive të rënda ose në rast përsëritjeje;

b) për shkeljet nga ana e punonjësve të institucioneve publike zbatuese të këtij ligji të detyrimeve të përcaktuara në nenet 27, pika 2, dhe 35, të tij, nis procedimin disiplinor dhe merr masa, në përputhje me rregullat e Kodit të Punës ose ligjin e nëpunësit civil, sipas përkatësisë së punonjësit;

c) për shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në nenet 37 dhe 38, të këtij ligji, zbaton dispozitat e kundërvajtjeve administrative të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik;

ç) shpërblimin e dëmit, nëse është shkaktuar një i tillë.

3. Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror kryen gjithashtu inspektime në bazë të shkeljeve të konstatuara nga monitorimet e kryera nga Shërbimi Social Shtetëror.

4. Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, kur vlerëson se janë konsumuar elementet e veprës penale nga personat përgjegjës, bën kallëzimin penal pranë autoriteteve kompetente.

5. Çdo shkelje e menaxhimit të fondeve buxhetore, që programohen dhe përdoren për shërbimet e kujdesit shoqëror, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas përcaktimeve të legjislacionit për menaxhimin e sistemit buxhetor.

6. Për çdo masë të marrë nga Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore.

7. Të gjitha të ardhurat nga gjobat e vendosura, sipas këtij neni, derdhen tërësisht në Buxhetin e Shtetit.

Neni 50

Ankimi

1. Kërkuesi/përfituesi i shërbimeve shoqërore, kur gjykon se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë, mund të paraqesë ankesë me shkrim pranë njësisë së qeverisjes vendore/Shërbimit Social Shtetëror brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit. Struktura vendore shqyrton ankesën dhe njofton me shkrim ankuesin, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së ankesës.

2. Kërkuesi/përfituesi i shërbimeve shoqërore ka të drejtë të paraqesë ankesë me shkrim pranë Inspektoratit të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së përgjigjes nga njësia e qeverisjes vendore/Shërbimi Social Shtetëror, pas ezaurimit të ankimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, pas shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, njofton me shkrim të interesuarin dhe njësinë e qeverisjes vendore/Shërbimin Social Shtetëror brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së ankesës.

4. Kërkuesi/përfituesi i shërbimeve shoqërore, që pretendon se i është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë ligjore, gëzon të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 51

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3, pika 29; 8, pika 5; 15, pika 5; 23, pika 3; 24, pika 5; 29, pika 5; 32, pika 2; 34, pika 4; 39, pikat 1 dhe 2; 42, pika 1; 43, pika 4; 46, pika 2; 47, pika 4; dhe 48, pika 2, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Kryeministri që, brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 32, pika 3; dhe 34, pika 5, të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet sociale që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 24, pikat 4 dhe 6; 26, pika 2; 27 pika 3; 35, pika 4; 40, pika 2; dhe 46, pika 3, të këtij ligji.

Neni 52

Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha qendrat rezidenciale dhe ofrimi i shërbimeve rezidenciale u transferohen njësisë të qeverisjes vendore.
2. Dispozitat apo pjesët e dispozitave të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, që trajtojnë shërbimet e kujdesit shoqëror, shfuqizohen.
3. Aktet nënligjore, që rregullojnë veprimtaritë e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja, në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj.

Neni 53

Shfuqizime

Në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, bëhen këto shfuqizime:

1. Neni 4, pikat 5, 15 dhe 16, nenet 6, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 20, pika 4, 22, 23 dhe 24.
2. Në pikën 1, të nenit 26, fjalët "dhe të shërbimeve shoqërore, normave dhe standardeve të shërbimeve, si dhe kontrollin e zbatimit të tyre në të gjitha nivelet e strukturave qendrore dhe vendore, në sektorin publik dhe privat".
3. Neni 27, pika 5, shkronjat "b" e "c", pikat 6 dhe 7.
4. Neni 29, pikat 3, 4, 5, 6, 8 dhe 12.
5. Neni 31, shkronja "a", fjalët "dhe nevojat e individëve për shërbime të përkujdesit shoqëror", shkronja "c", fjalët "dhe personat që do të trajtohen me shërbime të përkujdesjes shoqërore", shkronjat "ë", "f", shkronja "g", fjalët "dhe të personave që kanë nevojë për shërbime të përkujdesjes shoqërore", dhe shkronja "gj", të këtij neni.
6. Neni 32, neni 33, fjalët "dhe shërbimeve shoqërore", dhe nenet 37, 38, 39, 42/4.
7. Kudo në ligj, fjalët "dhe shërbimet" dhe "shërbimet e përkujdesjes shoqërore" shfuqizohen.

Neni 54

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 24.11.2016

Shpallur me dekretin nr. 9886, datë 6.12.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani